



GAZI NATYROR SI OPSION PËR TRANZICION TË QËNDRUESHËM TË ENERGJISË NË KOSOVË

Analizë Politikash

Mars 2022

www.indep.info

Gazi Natyror si Opsion për Tranzicion të Qëndrueshëm të Energjisë në Kosovë

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillimi i qëndrueshëm**

Publikimi: **Mars, 2022**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë punim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo opinionet e donatorëve të INDEP-it, bashkëpunëtorëve apo Bordit të INDEP-it.

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive	2
1. Hyrje	5
2. Metodologjia	7
3. Gjendja aktuale e sektorit të gazit natyror në Kosovë	8
4. Angazhimet e Kosovës drejt dekarbonizimit në BE dhe TKE	11
5. Mësime nga pesë rastet studimore - “Gazi natyror si burim tranzicioni i energjisë ”	12
5.1. Rasti i Shteteve të Bashkuara.....	13
5.2. Përshkrimi i rastit Gjerman.....	16
5.3. Përshkrimi i rastit të studimit Polak.....	19
5.4. Përshkrimi i rastit të studimit Bullgar.....	22
5.5. Përshkrimi i rastit të studimit të Maqedonisë së Veriut.....	24
6. Opsionet për gazin natyror si si burim tranzicioni energjetik në Kosovë.....	27
6.1. OPSIONI 1. Futja e gazit natyror nëpërmjet Shqipërisë - Gazsjellësi TAP	36
6.2. OPSIONI 2. Futja e gazit natyror përmes gazsjellësit në Maqedoninë e Veriut	39
6.3. OPSIONI 3. Vendosja e LNG-së në shkallë të vogël në “tubacionet virtuale të Kosovës” 40	
6.4. OPSIONI 4. Ndërtimi i termocentralit me gaz natyror në Kosovë.....	42
7. Përfitimet klimatike dhe dekarbonizimi duke përdorur gazin natyror si burim energjie.....	44
8. Përfundime.....	49
9. Rekomandime	52

Përmbledhje ekzekutive

Rritja e sigurisë së furnizimit me energji dhe diversifikimi i burimeve energjetike shihet si një nga komponentët më të rëndësishme të objektivave strategjike për zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë. Për më tepër, ky komponent është në përputhje me objektivat e ardhshme për dekarbonizimin dhe decentralizimin e tregut. Prandaj, zhvillimi potencial i sektorit të gazit natyror në Kosovë në përputhje me zhvillimet e infrastrukturës rajonale të gazit, shihet si një mundësi e madhe për të mbështetur këtë tranzicion. Për sa i përket tranzicionit të energjisë, gazi duket të jetë burimi më i qëndrueshëm i cili ofron fleksibilitetin e nevojshëm për integrimin e burimeve të ripërtëritshme. Për më tepër, kyçja në linjat rajonale të furnizimit me gaz natyror është një mundësi e rëndësishme dhe e dobishme për Kosovën si në aspektin e rritjes së sigurisë energjetike të furnizimit dhe diversifikimit të burimeve të energjisë, ashtu edhe në aspektin e rritjes së përgjithshme ekonomike.

Aktualisht, janë duke u zhvilluar një numër i projekteve të infrastrukturës kritike të gazit (tubacionet e furnizimit dhe ndërlihdësit në shtetet fqinje) që mund të mbështesin diversitetin dhe sigurinë e furnizimit me energji në Kosovë. Si e tillë, opsionet e furnizimit me gaz në Ballkanin Perëndimor pritet të rriten me ndërtimin e Gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP), alternativat e furnizimit të Kaspikut dhe importin e LNG-së nga Greqia ose Kroacia. Fluksi i parashikuar i furnizimeve konkurruese të gazit në rajon do të rezultojë me stabilitet çmimesh dhe tepëri të furnizimit që do të mbështesë zhvillimin e industrisë së gazit natyror të Kosovës. Këto projekte janë gjithashtu në përputhje me objektivat e përgjithshme të KE-së dhe promovojnë bashkëpunimin dhe integrimin e tregut; të dyja parakushte për integrim në BE.

Duke marrë për bazë se aktualisht nuk ka sisteme të cilat janë plotësisht miqësore ndaj ambientit, çdo sistem ka kostot e tij të imponuara ndaj ambientit, qoftë në ndotje ose në një lloj kontaminimi të burimeve natyrore. Për shembull, panelet diellore ndërtohen duke përdorur materiale shumë toksike. Turbinat e erës në kohët e fundit kanë shkaktuar vdekjen e mijëra zogjve sepse lartësia e tyre dhe valët e zërit tërheqin shpendët fluturues. Hidrocentralet janë mjaft të pastërta, por kanë shkatërruar ose ndryshuar habitatet natyrore të peshqëve dhe gjallesave të tjera ujore. Energjia bërthamore prodhon mbetje që janë shumë të rrezikshme.

Duke pasur parasysh këtë, atëherë ekziston mundësia që gazi natyror të bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm në mbështetje të Kosovës për të trajtuar të ashtuquajturën Trilemën Energjetike: dekarbonizimin, , sigurinë e furnizimit dhe energjinë e e përballueshme. Është vërtetuar se zëvendësimi i drejtpërdrejtë i thëngjillthëngjillit me gaz natyror për prodhimin e energjisë elektrike redukton jashtëzakonisht emetimet e gazrave serë.¹ Gazi natyror ka një të ardhme të ndritur afatmesme dhe afatgjatë, për sa kohë që industria e gazit pranon tranzicionin e energjisë dhe rreshtohet me burimet e ripërtëritshme për të prodhuar produkte pa karbon, veçanërisht hidrogjen, duke përfshirë gjithashtu gjetjen, përdorimin dhe ruajtjen e karbonit. Gazi natyror ka disa përparësi të rëndësishme.

¹ Mac Kinnon, M et al. (2018). The role of natural gas and its infrastructure in mitigating greenhouse gas emissions, improving regional air quality and integrating renewable sources, Energy and Combustion Science.

Ai është jashtëzakonisht i adaptueshëm dhe mund të përdoret për shumë qëllime si për ngrohje, ftohje, gatim, depozitim të mbeturinave, transport dhe si lëndë ushqyese për kimikate, plehra dhe produkte farmaceutike.

Tranzicioni i energjisë ka të bëjë me parashikimin dhe zbatimin e ndryshimit nga një shtet në tjetrin ose, më konkretisht, nga një sistem ekzistues në një sistem energjie të ri dhe më të pastër. Në ish-shtetet postkomuniste të Evropës Lindore dhe Qendrore, tranzicioni i energjisë kuptohet më tepër si kalimi nga sistemet e planifikuara në mënyrë qendrore dhe shpesh me intensitet të lartë të karbonit në sisteme të bazuara në treg dhe të përqendruara në efikasitet të energjisë.² Në fakt, kapaciteti i gazit natyror për të prodhuar një rezervë relativisht të ulët të karbonit gjatë kohës së pikut të përdorimit të energjisë në vend të rolit tradicional të ngarkesës bazë gjatë gjithë orarit mund të jetë kontributi i tij më domethënës në tranzicionin e energjisë.³ Gazi natyror si opsion në tranzicionin e qëndrueshëm të energjisë në Kosovë është gjithashtu një plotësues/zëvendësues i mundshëm për energjinë e ripërtëritshme sepse mund të kompensojë ndërprerjen e energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme – pra kur mungojnë era ose rrezet e diellit.

Deri më tani, Kosova ka qenë e përfshirë në një numër inicativash në nivel ndërkombëtar, siç është Deklarata e Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor e nënshkruar në nëntor të vitit 2020, ku Kosova u zotua që deri në vitin 2050 të bëhet një vend neutral ndaj klimës për sa i përket energjisë, ekonomisë qarkore, ndotjes, bujqësisë dhe biodiversitetit. Si rezultat, Kosova duhet të fokusohet që: të ketë sinergji ndërmjet të gjitha strategjive zhvillimore relevante në Kosovë dhe të zhvillojë një strategji afatgjatë energjetike me një plan të qartë, si dhe të përcaktojë datën kur do të ndalojë përdorimin e thëngjillit meqë është e qartë se kapacitetet e vjetruara të thëngjillit janë joefikase, të shtrenjta për të i përdorur, dhe i shkaktojnë dëme të mëdha shëndetit të qytetarëve dhe mjedisit. Atyre iu ka mbaruar jetëgjatësia dhe paraqesin kërcënim të drejtpërdrejtë për stabilitetin energjetik në Kosovë, siç edhe është dëshmuar në ngjarjet e fundit.

Vendosja e një mekanizmi çmimor të karbonit është vërtetuar të jetë një nxitje kryesore për daljen graduale nga përdorimi i thëngjillthëngjillit, duke lënë hapësirë për tranzicionin e energjisë. Mekanizmat e çmimit të karbonit (CPM) që vendosin tarifa për emetimet në sektorët e energjisë dhe ato industriale mund të jenë një mjet i fuqishëm ndikimi në modelet aktuale të prodhimit dhe konsumit. Vendet e Ballkanit Perëndimor u zotuan që do të harmonizojnë përpjekjet e tyre për zbutjen e ndryshimeve klimatike me objektivat dhe programet e BE-së në Deklaratën e Sofjes⁴.

Politikbërësit kanë deklaruar se çmimi i karbonit është një nga mjetet më të rëndësishme për të përmbushur premtimet politike. Si rezultat, vazhdimi i harmonizimit me Skemën e Tregtimit të Emisioneve të BE-së, si dhe puna drejt vendosjes së instrumenteve të tjera të çmimit të karbonit për

² S. Bouzarovski (2009). East-Central Europe's changing energy landscapes: a place for geography Area, 41 pp. 452-463

³ UNECE (2019). How natural gas can support the uptake of renewable energy, available at: https://unece.org/DAM/energy/se/pdfs/CSE/PATHEAYS/publ/NG_RE.pdf

⁴ European Commission (2020). Action Plan for the Implementation of Sofia Declaration, available at: <https://www.rcc.int/docs/596/action-plan-for-the-implementation-of-the-sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-western-balkans-2021-2030>

të promovuar dekarbonizimin në Kosovë është një obligim. Megjithatë, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë pak përvojë me iniciativat për çmimet e karbonit, duke përfshirë Shqipërinë dhe Malin e Zi të cilat kanë ndërmarrë disa hapa tentativë më parë.

Për më tepër, ndërtimi i kapaciteteve të reja duhet të sigurojë prodhimin e energjisë elektrike nga gazin natyror dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë për të siguruar largimin gradual nga përdorimi i thëngjillit. Këto objektiva duhet të jenë mjaft ambicioze në mënyrë që Kosova të jetë në rrugën drejt neutralitetit klimatik deri në vitin 2050. Kështu, një nga mundësitë e diskutuara në këtë punim është investimi në një impiant të ri CCGT me gaz me mundësi akumulimi të energjisë me bateri që mund të zëvendësojë impiantet e vjetra të linjtit dhe të reduktojë emetimet e karbonit.

Duke mos lënë anash përfitimet mjedisore të gazit natyror në krahasim me linjtin duke ditur se Prishtina si kryeqytet dhe qytetet e tjera të mëdha të Republikës së Kosovës vuajnë nga cilësia e dobët e ajrit, veçanërisht në dimër. Për të zgjidhur këtë çështje, autoritetet duhet të intensifikojnë përpjekjet për të nxitur dhe zhvilluar procesin e gazifikimit në vendin. Prandaj, në terma afatgjatë, investimet në infrastrukturën e gazit do të ofrojnë bazën për hapin tjetër ndaj mbrojtjes së mjedisit, meqë ato mundësojnë futjen e gazit të dekarbonizuar sapo të jetë i disponueshëm dhe konkurrues, e që favorizon reduktimet më të mëtejshme të dioksidit të karbonit dhe ul ndikimin e ndotjes së ajrit. Pra, këto investime do të sigurojnë të ardhmen e furnizimit me energji për vendin. Sipas IEA, që nga viti 2010, kalimi nga thëngjilli në gaz ka kursyer rreth 500 milion ton CO₂ - një efekt i barabartë me vënien e 200 milion automjeteve elektrike shtesë (EV) në rrugë, me energji elektrike me zero karbon në rrugë gjatë periudhës së njëjtë.

Aktualisht, çështjet e furnizimit dhe zgjerimit të gazit natyror nuk kanë arritur të marrin vëmendjen e duhur në Kosovë, qoftë brenda qeverisë apo në diskutimet e shoqërisë civile. Me këtë dokument politikash, ne synojmë të kontribuojmë në adresimin e kësaj zbrastësie. Si rrjedhojë, ky punim fokusohet në mundësitë e futjes së gazit natyror në Kosovë. Kontributi kryesor i këtij punimi përqendrohet në ofrimin e një pasqyre të dinamikave kryesore që mbështesin mundësitë e tranzicionit të qëndrueshëm të energjisë me përdorimin e gazit natyror në Kosovë. Kështu, ky dokument synon të informojë publikun e gjerë dhe zyrtarët publikë për të kuptuar gazin natyror si një “burim tranzitor” dhe një opsion për tranzicionin energjetik në Kosovë, si dhe për përfitimet nga zhvillimi i infrastrukturës së gazit dhe integritetit të tij në strukturën energjetike të Kosovës.

Ky punim përpiqet të përgjigjet se ku përshtatet gazin natyror në tranzicionin e qëndrueshëm të energjisë në Kosovë dhe ofron analizat dhe rastet studimore në vijim::

- Analizën e situatës aktuale të gazit natyror duke përfshirë infrastrukturën dhe kornizën legjislativë në Kosovë;
- Pesë (5) raste studimore (praktikat më të mira për gazin natyror nga SHBA dhe vendet e BE-së);
- Katër (4) opsione për përdorimin e gazit natyror si lëndë djegëse në tranzicion në Kosovë; dhe
- Përfitimet klimatike dhe mjedisore të gazit natyror kundrejt procesit të dekarbonizimit.

Kosova duhet të bëjë progres dramatik drejt diversifikimit të furnizimeve të saj me energji, veçanërisht me gaz natyror. Për këtë nevojitet vullnet politik, si dhe bashkëpunim i përmirësuar rajonal, i cili do të rezultojë në përfitime të konsiderueshme ekonomike duke ulur cenueshmërinë e vendeve ndaj presionit të krizave energjetike nga bota jashtme. Ne duhet t'i japim fund heshtjes për rolin e gazit natyror në strukturën e ardhshme energjetike të Kosovës, kështu që futja e gazit natyror mbetet një opsion i zbatueshëm. Prandaj, të kuptuarit e situatës aktuale dhe të ardhshme të zhvillimeve të gazit në Kosovë është me rëndësi të madhe si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat.

1. Hyrje

Opsionet e furnizimit me energji elektrike të Kosovës janë shumë të kufizuara për shkak të mungesës së burimeve të ripërtëritshme, infrastrukturës së vjetruar dhe jo të besueshme të prodhimit me linjit, mungesës së generatorëve fleksibël, mungesës së furnizimit në vendet fqinje (veçanërisht gjatë kohës kur ka kërkesë të madhe për energji, duke kufizuar kapacitetin e Kosovës për të importuar energji elektrike të modular), si dhe mungesa e burimeve të gazit natyror ose infrastrukturës për të importuar gaz.⁵ Qysh në filltet e vitit 2022, vërehet se Kosova është në një udhëkryq sa i përket çështjeve të energjisë elektrike dhe gazit natyror, duke u përballur me një sërë çështjesh kritike dhe shumë dimensionale me të cilat ballafaqohen rregullatorët e Kosovës, politikëbërësit dhe palët e tjera të interesit. Kosova, e cila u detyrua që në muajin dhjetor 2021 të bëjë ndërprerje sistematike dhe të përkohshme të energjisë elektrike, duhet të përshpejtojë investimet në ngrohje qendrore sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë që të reduktojë kërkesën për energji elektrike. Vendi është në majë të transformimit të sektorit të energjisë që mund të nxitet nga gazi natyror. Qëllimet e saj ambicioze ekonomike dhe sociale, kërkojnë përparim të përshpejtuar në zgjerimin e kapaciteteve energjetike. Prandaj, ne mendojmë se kjo mund të arrihet përmes investimit në burime të pastra të energjisë, të plotësuara me përdorimin e menjëhershëm të gazit natyror si lëndë djegëse tranzitore e pastër. Për të adresuar perspektivën e frikshme të rritjes së kërkesës për energji në dekadat e ardhshme, gazi natyror ofron një fuqi të pastër të ngarkesës bazë për për tranzicion dhe inkuadrim të energjisë së ripërtëritshme.

Aktualisht, gazi natyror është një nga lëndët djegëse më të rëndësishme për prodhimin e energjisë në shkallë të gjerë, dhe pa ndërprerje, krahas energjisë së prodhuar nga thëngjilli, termocentraleve bërthamore, hidrocentraleve dhe naftës. Nëse qëllimi është zvogëlimi i gjurmës së karbonit të prodhimit të energjisë sa më shpejt të jetë e mundur duke siguruar gjithashtu furnizim të vazhdueshëm, atëherë, *gazi natyror është një opsion evident*. Kjo për shkak se liron më pak karbon se thëngjilli ose nafta.⁶ Sipas gjetjeve nga dokumenti ACER, ka të ngjarë se gazi natyror do të vazhdojë të jetë një vektor kyç i energjisë në vitet e 2020-ta dhe potencialisht edhe më tej, për shembull në lidhje me ruajtjen e karbonit dhe si pjesë e tranzicionit të energjisë.

⁵ Ministry of Economy (2018) Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026, e çashtme në: https://mzheks.net/repository/docs/Energy_Strategy_of_the_Republic_of_Kosovo_2017_-_2026.pdf

⁶ UNECE (2019). How natural gas can support the uptake of renewable energy, available at: https://unece.org/DAM/energy/se/pdfs/CSE/PATHEAYS/publ/NG_RE.pdf

Në kontekstin e Kosovës, aktualisht vendi nuk ka qasje në tregun e gazit, nuk ka infrastrukturë, dhe nuk ka furnizime me gaz natyror. Korniza legislative dhe rregulluese është në fillet e saj. Megjithatë, ekzistojnë mundësi për të siguruar një rrugë të furnizimit me gaz natyror nga Maqedonia e Veriut ose nga Shqipëria nëpërmjet tubacioneve, si dhe LNG nga терминалет e afërta kryesore. Megjithatë, në një debat më të gjerë në Kosovë se si të dekarbonizohet sektori energjetik i vendit i cili është shumë i varur nga linjiti, qasja në furnizimin me gaz nëpërmjet tubacioneve apo rrugëve të tjera si një opsion i mundshëm nuk ka ndonjë vëmendje nga Qeveria për momentin. Megjithatë, debati është ende në vazhdim.

Prandaj, në vazhden e krizave të fundit energjetike, për të reduktuar varësinë e madhe të Kosovës nga thëngjilli, Qeveria e Kosovës duhet të eksplorojë gazin natyror si një burim alternativ të furnizimit me energji për të përmbushur kërkesën për ngrohje dhe energji elektrike. Përdorimi i drejtpërdrejtë i gazit natyror mund të kursejë paratë e konsumatorëve në faturat e ngrohjes, duke pasur gjithashtu një ndikim të rëndësishëm pozitiv mjedisor në vend. Në këtë kontekst, qëllimi i këtij punimi është të ofrojë një analizë të tranzicionit të qëndrueshëm të energjisë duke u fokusuar në zhvillimin e sektorit të gazit natyror në Kosovë. Ne demonstrojmë se narrativat të përqendruara rreth gazit natyror në Kosovë mund të jenë një rezultat i ndërtuar politikisht dhe shoqërisht që përfaqëson interesa të veçanta.

Pjesa e burimeve të ripërtëritshme për energji elektrike në Kosovë sipas të dhënave të fundit të Eurostat-it⁷ është 5.2%, dhe pjesa e mbetur 94.8% e ka origjinën nga thëngjillthëngjill. Kosova ka shumë pak ose aspak histori të përdorimit të gazit natyror ose produkteve të tij si një burim i veçantë energjetik. Për më tepër, Kosova aktualisht nuk ka treg të gazit natyror pasi i mungon burimi i prodhimit vendor të gazit dhe nuk është e lidhur me rrjetin rajonal të transmetimit të gazit. Ekziston një presion në rritje nga Bashkimi Evropian-BE (strategjia e sektorit të energjisë BERZH), Banka Botërore dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë ndaj Kosovës për të diversifikuar përbërjen e saj të furnizimit me energji për të zbutur varësinë e madhe nga thëngjillthëngjill dhe për të rritur furnizimet me energji nga burime të tjera (përfshirë zhvillimin dhe shpërndarjen e gazit).

Prandaj, është e rëndësishme të kërkohen burime të tjera të përbërjes së energjisë siç është gazi natyror. Si rezultat, Strategjia ekzistuese Kombëtare e Energjisë⁸ (objektivi i katërt, ka të bëjë me mbështetjen e projekteve të gazit natyror në Kosovë, siç është përfshirja e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) i cili ofron disponueshmëri oportuniste të lidhjes së Kosovës në këtë rrjet) dhe parashikon planet për të rritur sigurinë afatgjate energjetike duke diversifikuar përbërjen e furnizimit me energji si dhe zhvillimin e gazit.

Sidoqoftë, duhet të kemi parasysh se kalimi në gaz natyror do të varet nga siguri i furnizimeve të qëndrueshme me gaz me kosto të ulët. Pamundësia për të siguruar furnizime të besueshme të gazit natyror me çmime konkurruese do të kufizojë numrin e klientëve që eventualisht konvertohen, duke

⁷ Statistical Office of the European Communities, Eurostat Database (2020). *Eurostat*. Luxembourg, available at: <https://ec.europa.eu/eurostat/ëeb/energy/data/shares>

⁸ Ministria e Ekonomisë (2017), Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026, e çasshme në: https://mzheks.net/repository/docs/Energy_Strategy_of_the_Republic_of_Kosovo_2017_-_2026.pdf

ngadalësuar rritjen e përgjithshme të industrisë. Supozohet se do të kërkohet një formë ndihme nga qeveria ose subvencione të tjera për të mbuluar pjesën më të madhe të kostos për shumicën e familjeve, veçanërisht familjet me të ardhura të ulëta, në mënyrë që të jenë të gatshme për t'u lidhur me shërbimin e gazit natyror.

Progresi në dekarbonizimin e energjisë tashmë është duke u zhvilluar dhe duhet të përshpejtohet në një periudhë të afërme, dhe jo të synohet në periudhë afat-mesme dhe afat-gjatë. Kemi parasysh që BE-ja më në fund pranon se gazi natyror dhe bërthamor janë çelësi për dekarbonizim dhe mund të konsiderohen si investime të gjelbra.⁹ Kostoja e ofruar e gazit natyror si burim energjie me vendosjen e çmimit të karbonit pritet të jetë më e lirë se sa burimet e karburantit me bazë thëngjillithëngjill dhe energjia elektrike në Kosovë, pasi zëvendësimi dhe riparimi i objekteve të vjetra dhe joefikase Kosova A dhe Kosova B përfundimisht do të rrisin koston e energjisë elektrike. Konsumatorët të cilët kalojnë në përdorimin e drejtpërdrejtë të gazit natyror mund të paguajnë fatura më të ulëta për të njëjtën sasi të energjisë së konsumuar. Prandaj, në kuadër të rrugës së dekarbonizimit dhe rritjes së kërkesës për energji elektrike në vitet e ardhshme, Qeveria e Kosovës (QK) duhet të favorizojë përdorimin e gazit natyror në strukturën e saj energjetike.

2. Metodologjia

Qasja e aplikuar metodologjike përfshin raste studimore, analiza krahasuese, intervista gjysmë të strukturuar dhe fokus grupe. Metodologjia është përcaktuar nga natyra specifike e këtij hulumtimi dhe nga fakti që sektori dhe subjekti i analizuar janë strategjikë nga pikëpamja e ekonomisë së vendit, gjë që imponon konfidencialitetin e disa të dhënave që lidhen me studimet dhe përcakton mundësinë e publikimit të tyre. Shqyrtimi i literaturës i mbështetur nga një seri intervistash me palë të interesit ofron bazën për një analizë dhe vlerësim cilësor të statusit aktual dhe potencialit të ardhshëm për gazin natyror në Kosovë. Ky punim synon të ofrojë një vështrim më të afërt në tranzicionet e mëparshme të energjisë në interes të vënies në pah të njohurive që do të ishin të dobishme në të ardhmen. Një analizë e mundësisë që gazi të mbështesë përparimin e Kosovës drejt një të ardhmeje energjetike të dekarbonizuar.

Metoda kryesore e hulumtimit ka qenë kryesisht përmes intervistave gjysmë të strukturuar të mbajtura në mënyrë virtuale me palët përkatëse të interesit si dhe përmes të dhënave dytësore, siç janë, rishikimi i literaturës. Qasja e përgjithshme ndaj këtij procesi kërkimor ka qenë mbledhja e informacionit ekzistues mbi sektorin e gazit nga institucionet qeveritare të cilat merren me sektorin e gazit ose burime të tjera të kredibile publike, dhe intervista me autoritetet publike përkatëse përmes platformave online ose takimeve individuale. Pra, metodologjia e hulumtimit ishte deduktive: ofron një rishikim të studimeve ekzistuese të gazit në Kosovë, identifikon aktorët e sektorit të gazit, mbledh të dhëna të tjera (raporte, analiza dhe rishikim të gjetjeve, etj.) relevante për sektorin e gazit.

⁹ EU Commission, available at: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_22_2

Si rezultat, analiza në këtë punim përfshin të dhëna të marra përmes dokumenteve qeveritare (ligje, strategji, plane veprimi, udhëzime administrative dhe raporte të tjera në sektorin e gazit) burime online, si studimi paraprak i fizibilitetit Kosovë-Shqipëri, raportet e fundit të sektorit të gazit nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për Kosovë dhe gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, rishikimi i dokumenteve të projektit të gazit natyror nga rajoni dhe raportet e gazit të BERZH-it, raportet e Bankës Botërore (BB) për zhvillimet e gazit në rajon, dokumentet e qeverisë së Kosovës, studime të ndryshme për gazin natyror në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, etj.

Në analizën e parë, ne shqyrtojmë literaturën ekzistuese për gazin natyror për Kosovën dhe vendet fqinje. Hulumtimi i literaturës përkatëse akademike është bërë duke kombinuar fjalë të ndryshme kyçe në internet si: *gazi natyror si burim tranzicioni, Kosovë, dekarbonizimi, tranzicioni i energjisë, gazit në Ballkanin Perëndimor, etj.*, duke u limituar në fushat e infrastrukturës së gazit, gazit natyror, dhe periudha nga 2002 deri në 2022 për t'u fokusuar kryesisht në zhvillimet më të fundit rreth gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së. Mbi 50 dokumente si burime të nxjerrura nga interneti ashtu edhe ato të shtypura duke përfshirë studimet e fizibilitetit, raportet, artikujt e gazit natyror për rajonin, janë identifikuar si burime relevante për gazin natyror në Kosovë dhe rajon.

Për më tepër, rishikimet e dokumenteve kanë eksploruar situatën aktuale të gazit në Kosovë, legjislacionin e saj, masat dhe rezultatet e mundshme të studimeve të fizibilitetit për zhvillimin e gazit; opsionet më të mira të politikave të përdorura për gazin si burim energjetik në Kosovë; shembuj të praktikave më të mira nga SHBA dhe katër vende të BE-së, përkatësisht Gjermania, Polonia, Bullgaria, vendi fqinj Maqedonia e Veriut, si dhe faktorët që ndikojnë në proceset e politikës së gazit. Më pas, ne shqyrtoam përvojën dhe mësimet e hershme nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor lidhur me zhvillimin e infrastrukturës së gazit. Punimi përfundon duke vënë në dukje përfundimet dhe rekomandimet.

3. Gjendja aktuale e sektorit të gazit natyror në Kosovë

Industria e gazit natyror ose tregu i gazit nuk ekziston në Kosovë (përdoret pak LPG).¹⁰ Nuk ka infrastrukturë ose infrastruktura ekzistuese është shumë kufizuar për transportin e gazit në Kosovë (p.sh. pjesa e shkurtër nga Prishtina në drejtim të Maqedonisë së Veriut; rrjeti i mëparshëm për gazin nga gazifikimi i thëngjillit).¹¹ Pavarësisht miratimit të legjislacionit parësor në sektorin e gazit natyror, shumë pak aktivitete janë zhvilluar për të mundësuar miratimin e legjislacionit dytësor për tregun e gazit. Sipas raportit të implementimit nga Komuniteti i Energjisë 2020 dhe 2021¹², krijimi i një kornize adekuate rregullative është vendimtare për të ardhmen e furnizimit me gaz të Kosovës.

¹⁰ Energy Community Secretariat (2020). Annual Implementation Report 2020, available at: <https://www.energy-community.org/implementation/IR2020.html>

¹¹ Personal Interview with the public official from the ERO.

¹² Energy Community Secretariat (2020). Annual Implementation Report 2020

Në kuadër të legjislacionit, ligji kryesor që përfshin legjislacionin e BE-së për gazin natyror në Kosovë është *Ligji nr. 05/L-082 për Gazin Natyror*¹³, i miratuar në vitin 2016, i cili përdor dispozita nga paketa e tretë e energjisë. Ky ligj specifikon organizimin dhe funksionimin e sektorit të gazit natyror, qasjeqasjen në treg, kriteret dhe procedurat e zbatueshme për dhënien e autorizimeve për transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, përdorimin dhe ruajtjen e gazit natyror dhe funksionimin e sistemeve.

Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e dispozitave më të rëndësishme të Ligjit për Gazin Natyror nuk janë zbatuar ende, për shkak të kushteve të parashikuara me ligj që një dispozitë e tillë duhet të zbatohet vetëm përpara hyrjes së parë të gazit natyror. Përveç legjislacionit primar ekziston edhe *akti nënligjor*, Udhëzimi Administrativ (UA) Nr. 08.2017 për sigurinë e furnizimit me gaz natyror.

Ky UA synon të vendosë masa për sigurinë e furnizimit me gaz natyror si dhe rregulla për ruajtjen e nivelit adekuat të sigurisë së furnizimit, duke siguruar funksionimin e duhur dhe të vazhdueshëm të tregut të brendshëm të gazit natyror. Janë miratuar dy rregulla të rëndësishme të cilat dalin nga Ligji për Rregullatorin e Energjisë: Rregulli për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë¹⁴ i cili përfshin gjithashtu gazin natyror si dhe Rregulli për Integritetin dhe Transparencën e Tregut të Energjisë me Shumicë (REMIT).¹⁵ Një akt tjetër dytësor i rëndësishëm i miratuar në lidhje me sektorin ndërkufitar të gazit, (acquis në infrastrukturë) është adaptimi i Rregullores (BE) 347/2013 mbi udhëzimet për infrastrukturën energjetike trans-evropiane. Si rezultat, Kosova¹⁶ është një nga të t Palët e pakta Kontraktuese që ka adaptuar tashmë këtë Rregullore (BE) 347/2013.

Dokumentet kryesore të politikave në fushën e energjisë (përfshirë gazin) janë *Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026 dhe Programi për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë 2018-2020*. Udhëzimet e përgjithshme të politikës së qeverisë së Kosovës në lidhje me sektorin e gazit natyror janë përcaktuar në Strategjinë aktuale të Energjisë 2017-2026¹⁷. Strategjia (objektivi i saj i katërt) fokusohet në zhvillimin e infrastrukturës së gazit natyror si një burim alternativ i furnizimit me energji për të përmbushur kërkesën për ngrohje dhe energji elektrike në vend dhe për të mbështetur qytetarët që kalojnë nga ngrohja me dru, naftë dhe burime të tjera në ngrohje qendrore. Ky është një indikator i përpjekjeve të Qeverisë së Kosovës (QK) për të promovuar gazin dhe për të vepruar si një pikënisje e mirë.

¹³ Gazeta Zyrtare e Qeverisë së Kosovës, Ligji nr. 05/L-082 për Gazin Natyror, e qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12688>

¹⁴ Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës, Rregulla për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, e disponueshme në: http://ero-ks.org/2017/Rregullat/07_2017_RREGULLA%20PER%20LICENCIMIN%20E%20AKTIVITETEVE%20TE%20ENERGJISE%20KOSOVE.pdf

¹⁵ Zyra e Rregullatorit për Energji të Kosovës, rregulli REMIT, e qasshme në: <https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Legjislacioni/Rregullat/Rule%20on%20Eholesale%20Energy%20Market%20Integrity%20and%20Transparency%20-%20Copy.pdf>

¹⁶ Energy Community Secretariat (2020). Kosovo Implementation Report 2020

¹⁷ Ministria e Ekonomisë (2017). Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026, e qasshme në: https://mzheks.net/repository/docs/Energy_Strategy_of_the_Republic_of_Kosovo_2017_-_2026.pdf

Për më tepër, Strategjia e rishikuar e Energjisë 2022-2031¹⁸, është në përputhje me Marrëveshjen e Gjellbër dhe Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, të cilat sigurojnë tranzicionin në një periudhë të re të politikës energjetike, duke siguruar furnizim të qasshëm, të sigurt dhe me cilësi të lartë të energjisë. Prandaj, furnizimi dhe konsumi i gazit në Kosovë është i kufizuar në shishe LPG (gazi i lëngshëm i naftës). Përveç mungesës së prodhimit të gazit në Kosovë, nuk ka kapacitet importi me tubacione. Kosova është neto importuese e produkteve të hidrokarbureve¹⁹ kryesisht me origjinë nga vendet fqinje (Maqedonia Veriore, Greqia, Serbia dhe Kroacia).

Sipas zyrtarëve të ZRRE-së, kërkesa për gaz në Kosovë (bazuar në dy studime të bëra tashmë deri në vitin 2040) vlerësohet rreth 1 miliard metra kub. Ndërsa studimi ALGOKAP ka parashikuar kërkesë deri në 2 miliardë metra kub, por kjo është tepër e lartë²⁰. Megjithatë, politika e Qeverisë e bazuar në Strategjinë e Energjisë (2017-2026) është të promovojë dhe mbështesë lidhjen e Kosovës me projektet rajonale të furnizimit me gaz duke rritur sigurinë e furnizimit dhe diversifikimin e burimeve energjetike në Kosovë dhe konsiderohet si një element shumë i rëndësishëm për furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor me energji. Në këtë drejtim, zhvillimi i gazit në Kosovë, përmes linjave të projektit të gazit në vendet e rajonit, konsiderohet si një mundësi e mirë për furnizim të ardhshëm me gaz natyror. Lidhja me linjat rajonale të furnizimit me gaz është një opsion i rëndësishëm, duke pasur parasysh ndikimin pozitiv si në drejtim të rritjes së sigurisë energjetike, ashtu edhe në drejtim të rritjes dhe diversifikimit të burimeve të energjisë dhe zhvillimit ekonomik të vendit.²¹

Kosova pritet të ketë kompletuar sistemin e gazit natyror për nevojat e konsumit final, që do të përdoret si burim energjetik, për transformim në energji elektrike, termike apo i kombinuar dhe për ti shërbyer veçanërisht industrisë për furnizim me energji apo diversifikim deri në vitin 2030.²² Vlen të përmendet zhvillimi më i fundit kyç në sektorin e energjisë, nga dhjetori 2020, operatori i sistemit të rrjetit të energjisë elektrike të Kosovës, KOSTT, ka filluar të operojë në mënyrë të pavarur në të gjithë vendin si zonë rregullative dhe si pjesë e një blloku të ri energjetik me vendin fqinj, Shqipërinë. Si rezultat, Kosova është një hap më afër që të bëhet pjesë e Rrjetit Evropian të Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike (ENTSO-E) dhe më vonë edhe e ENTSO-G.²³ për gas.

Sipas Planit Zhvillimor të Transmisionit 2021-2030²⁴ i cili paraqet planin e zhvillimit të rrjetit të Kosovës për 10 vitet e ardhshme, faktor shumë ndikues në diversifikimin e burimeve të energjisë do të jetë zhvillimi i infrastrukturës së gazit. Pritet që në këtë periudhë 10-vjeçare, Kosova të ketë zhvilluar plotësisht ose pjesërisht rrjetin e transmetimit të gazit dhe një pjesë të rrjetit të shpërndarjes së gazit.

¹⁸ Personal interview with public official from the Ministry of Economy.

¹⁹ Zyra e Rregullatorit për Energji, Deklarata e Sigurisë së Furnizimit, e qasshme në [http://ero-ks.org/2019/Publikimet/Deklarate_mbi_Sigurine_e_Furnizimit_ne_Kosove\(energji_elektrike_gaz_natyror_naftes\)ZRRE_31_07_2019_eng.pdf](http://ero-ks.org/2019/Publikimet/Deklarate_mbi_Sigurine_e_Furnizimit_ne_Kosove(energji_elektrike_gaz_natyror_naftes)ZRRE_31_07_2019_eng.pdf)

²⁰ Personal Interview with the public officials from the Ministry of Economy

²¹ Personal Interview with the public official from the ERO

²² Personal Interview with the public official from the Ministry of Economy.

²³ European Network of Transmission System Operator for Gas, available at: <https://www.entsog.eu/about-entsog>

²⁴ KOSTT- Transmission Development Plan (2021-2030). available at: https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Konsultimet%20Publike/KOSTT_Transmission%20Development%20Plan%202021-2030.pdf

Pritet që pas finalizimit të projektit TAP, Kosova të lidhet me rrjetin e gazit natyror përmes projektit ALKOGAP.

Megjithatë, sfidat kryesore qëndrojnë në rrugën e marrjes së shpejtë të gazit natyror në sektorin e energjisë dhe në realizimin e rolit kyç të gazit në përmbushjen e sfidave të qasjes në energji, zgjerimit të kapaciteteve, diversifikimit dhe dekarbonizimit të sektorit energjetik të Kosovës. Sfidat tjera janë arritja e sigurisë dhe/ose pavarësisë më të madhe të energjisë, diversifikimi i ulët i energjisë, zbutja e ndikimeve negative mjedisore. Alternativat për furnizim pritet të rriten në Kosovë me zhvillimin e gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline, importet e LNG në Greqi dhe platformën Caspian Supply WBIF/EBRD. Zhvillimi i rrugëve të reja të gazit natyror (madje edhe me kapacitete fillestare modeste) do të diversifikonte burimet, furnizuesit dhe rrugët për konsumatorët në Ballkanin Perëndimor dhe Kosovë.

4. Angazhimet e Kosovës drejt dekarbonizimit në BE dhe TKE

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor janë anëtarë të Traktatit të Komunitetit të Energjisë (EnCT) dhe për këtë arsye ata duhet të bëjnë përpjekje për të arritur objektiva të ndryshëm dhe për të zbatuar *acquis* të BE-së për energjinë që është në qendër të këtij traktati. Gazi është një nga modelet kryesore të sektorit të energjisë në raportet e zbatimit për çdo vend, dhe zbatimi i *acquis*-së për gazin shikon ndarjen, qasjeqasjen e palëve të treta, tregun me shumicë, tregun me pakicë dhe ndërlihdjen.

Kosova si palë kontraktuese në TKE që nga viti 2006 duhet të përafrojë dhe zbatojë *acquis* e BE-së të renditur në nenin 10 të Traktatit²⁵, krijimin e Komunitetit të Energjisë. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) e vitit 2016, sa i përket energjisë, e vendos Komunitetin e Energjisë në bazën e integritit të Kosovës në tregjet energjetike të BE-së. Neni 114-Energjia, thekson se bashkëpunimi do të fokusohet në fushat prioritare që kanë të bëjnë me *acquis* të Komunitetit në fushën e energjisë (përfshirë gazin) dhe do të bazohet në Traktat, me qëllim të integritit gradual të Kosovës në tregjet energjetike të Evropës. Më tej, prioritetet afatmesme të *acquis* kapitulli 15-Energjia dhe kapitulli 21-Rrjetet trans-evropiane të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së kanë renditur dy studime të gazifikimit për Kosovën.

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovë 2020, (Energjia, pika 6.22., Faqe 97) thekson si në vijim:

Kosova është duke eksploruar mundësi për interkonektorë gazë me vendet fqinje. Më tej ceket përfundimi i studimit për gazsjellësin ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në bazë të projektit TAP, si dhe nisja e studimit të parafizibilitetit për gazsjellësin nga Maqedonia Veriore në Kosovë.

Kosova është gjithashtu pjesë e Lidhjes Energjetike të Evropës Qendrore dhe Juglindore (CESEC) e cila punon për të përshpejtuar integritin e tregjeve të gazit dhe energjisë elektrike në Evropën

²⁵ Energy Community Treaty (2006). Article 10 of the Treaty establishing the Energy Community, available at <https://www.energy-community.org/legal/treaty.html>

Qendrore dhe Juglindore. Nën CESEC, Komisioni do të vazhdojë të monitorojë nga afër reformat e tregut në Ballkanin Perëndimor, me qëllim që të përshpejtojë integrimin e tregjeve të gazit dhe energjisë elektrike të Evropës Qendrore dhe Juglindore. Kosova me vendosmërinë e saj për të vazhduar dhe përshpejtuar më tej përpjekjet drejt procesit të anëtarësimit në BE, ka nënshkruar Deklaratën e Sofjes, në Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor²⁶ që përkon me Marrëveshjen e Gjelbër të BE-së. Si rezultat, Kosova është përkushtuar për një sërë veprimesh si vendosja e instrumenteve të çmimit të karbonit dhe skemave të mbështetjes së burimeve të ripërtëritshme të bazuara në treg, si dhe heqja graduale e subvencioneve të thëngjillit.

Kosova ka qenë pjesë e procesit të integritimit evropian për më shumë se një dekadë, por ende i mungojnë politikat ambicioze dhe të fuqishme për klimën dhe energjinë për të çuar përpara tranzicionin energjetik në përputhje me Marrëveshjen e Parisit dhe Pakon për Energji të Pastër. Adaptimi dhe zbatimi i *acquis* të BE-së për energjinë ka qenë më i ngadalshëm dhe më pak efektiv se sa ishte parashikuar. Përkundër një shtytje të fortë nga BE-ja dhe Komuniteti i Energjisë, Kosova është përballur me vështirësi të mëdha, jo vetëm në përkrahjen e tranzicionit energjetik, por edhe në përmbushjen e disa kushteve bazë të politikës energjetike për BE-në. Angazhimi i Kosovës ndaj Agjendës së Gjelbër të BE-së për Ballkanin Perëndimor varet nga zhvillimi i planeve konkrete për procesin e dekarbonizimit.

5. Mësimet nga pesë rastet studimore - “Gazi natyror si burim tranzicioni i energjisë ”

Në sesionin vijues, ne përshkruajmë shembujt më të mirë nga pesë rastet e përzgjedhura studimore (SHBA, Gjermani, Poloni, Bullgari dhe Maqedoninë e Veriut) të përdorimit të gazit natyror për tranzicion energjetik. Përzgjedhjet e këtyre rasteve janë bërë në bazë të faktit se edhe këto vende mbështeten shumë në thëngjill siç është rasti i Kosovës. Rastet studimore të diskutuara në këtë punim na lejojnë të nxjerrim opsione për futjen e gazit dhe të ofrojmë disa përfundime tentative se si mund të arrihet kjo. Megjithatë, gjithmonë duhet të merren parasysh kontekstet e vendit specifik, në mënyrë që “mësimet e nxjerra” të mos gjeneralizohen dhe të shihen si një model për t'u zbatuar në kontekste të tjera politike. Analiza e rasteve studimore nga SHBA dhe katër vende evropiane sugjeron që politikëbërësit e Kosovës dhe palët relevante të interesit mund të përfitojnë nga shqyrtimi i skenarëve të mundshëm që mund të evoluojnë në dinamikën konkurruese të industrisë dhe tregtisë së bashku me integrimin e tregut dhe ekuilibrimin në planifikimin e tranzicionit energjetik. Prandaj, rastet e mëposhtme studimore në lidhje me tranzicionin e energjisë përmes përdorimit të gazit natyror shërbejnë si një burim i mirë i mësimet.

²⁶ European Commission (2020). Green Agenda for the western Balkan, available at: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/green_agenda_for_the_eestern_balkans_en.pdf

5.1. Rasti i Shteteve të Bashkuara

Shtetet e Bashkuara shihen vazhdimisht si një lider botëror në përdorimin e gazit natyror si lëndë djegëse në tranzicion me rritjen e përdorimit të gazit natyror në përbërjen e energjisë nga 19% në 38%.²⁷ Pasuar nga një varësi e lartë nga thëngjillthëngjill, qeveria ka zbatuar politika të ndryshme për të nxitur zhvillimin e saj të energjisë së pastër. Përderisa operatorët e impianteve të thëngjillthëngjill kërkojnë mënyra për të ripërdorur njësitë e tyre të vjetra në mënyrë që të shmangin transformimin e tyre në asete të bllokuara, konvertimi në gaz natyror ka qenë një strategji e miratuar gjerësisht në SHBA.

Rënia e prodhimit të thëngjillit mund të shpjegohet me ndryshimin e dinamikës së tregut dhe mjedisit rregullator federal. Historikisht, faktorët kryesorë që mbështesin transformimin e industrisë së thëngjillthëngjill në SHBA përfshijnë: i) mekanizimi në rritje i minierave të thëngjillit; ii) Akti i Ajrit të Pastër i vitit 1990 që ndikoi negativisht në kërkesën për thëngjill Appalachian në favor të thëngjillthëngjill perëndimor me squfur të ulët; iii) revolucioni i gazit argjilor që rezultoi në rënie dramatike të gazit natyror, dhe iv) rritjen e konkurrencës së burimeve të ripërtëritshme.²⁸ Nga viti 1980 deri në vitin 2008, pjesëmarrja e thëngjillthëngjill në prodhimin e energjisë elektrike është rritur në mënyrë dramatike me 83%. Shumica e termocentraleve me thëngjillthëngjill u ndërton para vitit 1980, të përcjellura nga njësi shtesë me gaz natyror në vitet 2000 dhe njësi të ripërtëritshme në fund të viteve 2000.²⁹ Sipas Administratës së Informacionit të Energjisë të SHBA-së, mes viteve 2011 dhe 2019, 121 njësi me thëngjill në SHBA u ripërdorën për të djegur lloje të tjera karburanti,. Përpjekjet e administratës Obama për dekarbonizim të përcaktuara në Planin e Energjisë së Pastër kanë vendosur kufizime të mëtejshme në emetimet e dioksidit të karbonit dhe gazeve të tjera serrë nga termocentralet me thëngjillthëngjill.³⁰

Vendimi që termocentralet të kalojnë nga thëngjillthëngjill në gaz natyror u nxit nga standardet më të rrepta të emetimeve, çmimet e ulëta të gazit natyror dhe teknologjia e re më efikase e turbinave me gaz.³¹ Përmirësimet teknologjike ishin të nevojshme për konvertimin nga thëngjillthëngjill në gaz, për të kthyer njësitë që të funksionojnë vetëm me ventilatorë të gazit natyror dhe nevojën për modifikimi të sistemeve të kontrollit si dhe kaldasë. Gjatë kësaj periudhe kohore, 104 impiante me thëngjillthëngjill adoptuan qasjen e dytë, duke konvertuar nxehësin me avull që të djegë lëndë tjera, më së shpeshti gaz natyror, megjithëse disa ishin konfiguruar që të djegin koksin e naftës (një nënprodukt i rafinerisë), materialet e mbeturinave nga letra dhe prodhimi i pulpës, ose mbetjet e ngurta të drurit.

²⁷ EIA US (2021). Natural gas in USA. Available at: <https://ëëë.eia.gov/energyexplained/natural-gas/use-of-natural-gas.php>

²⁸ Betz, Michael, et al. (2015). Coal mining, economic development, and the natural resources curse. *Energy Economics* 50: 105-116.

²⁹ US EIA. (2011). Age of electric power generators varies widely. available at: <http://ëëë.eia.gov/todayinenergy/detail.php?id=1830>

³⁰ Cama, Timothy. 2016. EPA chief: US must help coal country transition. *The Hill*, May 6, <http://thehill.com/policy/energyenvironment/279056-epa-chief-us-must-help-coal-countrytransition>

³¹ U.S. Energy Information Administration. Today, Energy. available at: <https://ëëë.eia.gov/todayinenergy/detail.php?id=44636>




Figure 1. Skema e pakos së Mitsubishi Hydaptive³²

Kalimi nga thëngjilli me karbon të lartë në gaz natyror me karbon më të ulët është një opsion reduktimi me veprim të shpejtë i disponueshëm në shumë rrjete globale. Në këtë rast studimi, ne shikojmë mekanikën e ndërrimit të karburantit nga thëngjillitëngjill në gaz në Shtetet e Bashkuara dhe diskutojmë se si ndikon në emetimet e dioksidit të karbonit. Gjatë viteve 2008 dhe 2017, prodhimi i thëngjillitëngjill ra prej 40%, ndërsa kapaciteti i tijthëngjill ra prej 13%. Shkallë më të ulëta të shfrytëzimit, në vend të mbylljes së impianteve, po nxisin rëniën: termocentrali mesatar i thëngjillitëngjill në SHBA operoi me një faktor kapaciteti prej 49 përqind në 2017, nga 67 përqind në 2008. Arsyeja kryesore për rëniën e thëngjillitëngjill është disponueshmëria e gazit natyror me çmim më të lirë. Kur një turbinë me gaz zëvendëson një njësi thëngjilli, emetimet e përgjithshme reduktohen me një mesatare prej 0.6t CO₂e/MËh. Kjo për faktin se gazi është më i pastër se thëngjillitëngjill dhe se turbinat me gaz janë më efikase.³³

Në SHBA konsumi i gazit është rritur në mënyrë dramatike që nga viti 2008, në kurriz të konsumit të thëngjillitëngjill. Ky ndryshim i karburantit ka bërë më shumë për të reduktuar emetimet e karbonit në Shtetet e Bashkuara gjatë dekadës së fundit se çdo faktor tjetër i vetëm, duke përfshirë ndërtimet e reja të ripërtëritshme. Ndërrimi operativ i karburantit, ose fillimi i një impianti në vend të një tjetri, është plotësisht i kthyeshëm. Ky nuk është rasti me ndryshimet strukturore të tilla si tërheqja e impianteve të thëngjillitëngjill ose instalimi i energjisë së ripërtëritshme. Megjithatë, ndryshimet strukturore kërkojnë kohë.

Rezultati ka qenë një rritje prej 70% në prodhimin e energjisë me gaz natyror që nga viti 2005, duke qenë se gazi tani është përgjegjës për një të tretën e gjenerimit total të energjisë elektrike në SHBA. Ka

³² NSEnergybusiness.Gas Turbines Hydrogen. Available at: <https://ëëë.nseenergybusiness.com/features/gas-turbines-hydrogen-us/>

³³ Poëering Past Coal. Available at: <https://ëëë.poëeringpastcoal.org/insights/coal-to-gas-sëitch-slashes-us-poëer-sector-co2>

Duke marrë parasysh planin e ngrohjes qendrore termike, është më efikase nëse Kosova investon në kompani të vogla të ngrohjes qendrore me orientim termik që do të prodhojnë sisteme të qëndrueshme të ngrohjes me standardet e komunitetit energjetik. Kjo do të reduktonte në mënyrë drastike emetimin nga kategoritë e tjera të elementeve të djegura nga amvisëritë, si dhe do të reduktonte rrënjësisht konsumin e energjisë gjatë stinës së dimrit në Kosovë. Konsumi i energjisë gjatë dimrit është dy herë më i madh se konsumi i verës në Kosovë. Nëse me këtë metodë, konsumi i energjisë rrafshohet dhe kompresohet në shifra më të ulëta, humbja e rrjetit gjithashtu do të bjerë dhe sistemet do të bëhen më të qëndrueshme. Konsumi i pritshëm i gazit natyror si për Shqipërinë ashtu edhe për Kosovën do të rritet deri në 2,121 mil. m³ gaz natyror në vitin 2040 nga të cilat 625 mil. m³ është për një CCGT potencial në Kosovë dhe 242 mil. m³ është për sistemet NQ CHP në qendrat kryesore të konsumit në Kosovë.⁷⁵ Studimi i Gazifikimit i Bankës Botërore/KfW i Evropës Juglindore ka marrë në konsideratë ekonominë e kalimit të gazit në Kosovë, marrë parasysh kërkesën për ngrohje nga ngrohtoret ekzistuese (Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë).

Gjenerimi total i këtyre ngrohtoreve është afërsisht 250 GWh/për vit, ose rreth 4-5% e kërkesës për ngrohje të Kosovës. Objektet e ngrohjes qendrore furnizojnë pjesët më të dendura me banim të qyteteve dhe objektet publike si spitalet, shkollat dhe ndërtesat administrative si dhe ndërmarrjet industriale.⁷⁶ Studimet kanë rekomanduar mundësinë e furnizimit me ngarkesë industriale dhe komerciale dhe ndërtimin e rrjeteve të distribucionit (shpërndarjes) së gazit, veçanërisht në Prishtinë dhe Mitrovicë (dy qytetet kryesore të analizuar nga studimi i lartpërmendur). Potenciali i kërkesës për gaz natyror është 1.2 bcm (duke marrë parasysh vetëm sektorët e industrisë, shërbimeve dhe banimeve kolektive) deri në afërsisht 2 bcm (duke marrë parasysh sektorët e industrisë, shërbimeve dhe banesave, NQ & Kogjenerimi dhe termocentralet 250 MË CCGT).⁷⁷

⁷⁵ Energy Community, Gas_13 / Albania – Kosovo Gas Pipeline (ALKOGAP), available at: <https://ëëë.energy-community.org/regionalinitiatives/infrastructure/PLIMA/Gas13.html>.

⁷⁶ Development and Evaluation of Power Supply Options for Kosovo (2011). Available at: https://dhinfrastructure.com/ëp-content/uploads/2015/03/Kosovo_generation_options_report_12312011.pdf

⁷⁷ Ibid.

Tabela 6. Kërkesa për gaz në Evropën Juglindore 2013-2025 (konsumi përfundimtar, në metër kub)

Country	2013	2025
Albania	6,842	523,741
Bosnia and Herzegovina	136,500	612,972
Bulgaria	1,666,526	2,499,495
Croatia	1,700,632	1,977,717
Greece	1,504,605	2,300,190
Kosovo*	0	207,858
North Macedonia	33,053	355,764
Montenegro	0	120,681
Romania	7,900,079	8,092,248
Serbia	1,226,816	1,726,638
TOTAL	14,175,053	18,417,303

Në kontekstin e furnizimit me gaz, d.m.th., infrastruktura ndërlidhëse dhe portet hyrëse të gazit, janë kritike për tranicionin e gazit në gjashtë vendet e BP dhe në Kosovë, pasi që ndikon në çmimet dhe investimet në termocentral. Integrimi i tregut siguron një kontekst të shumëllojshëm të furnizimit me gaz, që praktikisht do të thotë që gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor të kenë qasje në gaz më të lirë, më të sigurt dhe më fleksibël. Brenda një tregu rajonal dhe të integruar të gazit, ku investitorët marrin sinjalin e duhur në lidhje me kthimin e kapitalit të investimeve të reja të gazit, gjashtë vendet e Ballkanti Perëndimor me ekspozim të shtuar ndaj çmimeve të karbonit, si Kosova, mund të tërheqë investime në zhvillimin e infrastrukturës dhe të përshpejtojë zëvendësimin e lëndëve të ngurta. Tutje, Kosova më vonë mund të përdorë gazin si një burim balancues për të përshpejtuar dekarbonizimin e sistemit të saj energjetik. Kosova është në proces të zhvillimit të Planit të saj Kombëtar për Energjinë dhe Klimën për periudhën 2021-2030 me një perspektivë afatgjate deri në vitin 2050, si dhe në rishikimin e Strategjisë së saj të Energjisë për periudhën 2021-2030. Për më tepër, duke pasur parasysh fleksibilitetin e gazit si burim rezervë, gjurmën e tij më të ulët të karbonit dhe dështimin për të zhvilluar një TEC të ri të gazit natyror me thëngjill, pritet të marrë një rol edhe më të madh në të ardhmen.




Figura 4. Integrimi i plotë i çmimeve të karbonit në treg **Figura 5.** Integrimi Gradual i çmimeve të karbonit në treg.⁷⁸

⁷⁸ EnCT, Kantor, EM (2021). A carbon pricing design for the Energy Community, available at: https://ëëë.energy-community.org/dam/jcr:82a4fc8b-c0b7-44e8-b699-0fd06ca9c74d/Kantor_carbon_012021.pdf

Siç mund të shihet në projeksionet e perspektivës së gjenerimit të energjisë në figurën 4 dhe 5 më sipër, tërheqja nga thëngjilli në Kosovë mund të realizohet në vitin 2040 me integrimin e plotë të tregut, së bashku me çmimin e plotë të karbonit, mund të përshpejtojë tërheqjen nga thëngjilli. Në këto kushte, lloje të ndryshme të BRE-ve dominojnë prodhimin, të mbështetura nga fuqia e djegies së gazit dhe balancimit ndërkuftar.

Tabela 7. Zgjerimi i kapacitetit në Kosovë në MË nëpër projeksione: Full_CP_M (Çmimi i plotë i karbonit-integrimi i tregut) dhe Gr_CPM_int (. Integrimi Gradual i çmimeve të karbonit në treg)⁷⁹

	2015-2030					2030-2040				
	BSL	Gr_CP-M_Fr	Full_CP-M_Fr	Gr_CP-M_Int	Full_CP-M_Int	BSL	Gr_CP-M_Fr	Full_CP-M_Fr	Gr_CP-M_Int	Full_CP-M_Int
Nuclear	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Coal	(87)	(148)	(222)	(537)	(537)	-	-	-	(610)	(610)
Gas and Oil	-	-	-	149	222	-	-	-	455	379
Biomass	12	8	8	2	8	-	8	10	14	5
Hydro	89	89	156	156	156	-	67	-	-	-
Wind	135	137	143	139	206	43	55	85	154	101
Solar and others	167	176	213	176	291	41	133	103	171	45

Siç mund të shihet në tabelën 7 më sipër, në kuadër të integritit të plotë të çmimeve të karbonit në treg, kapacitetet e gazit natyror pas vitit 2030 do të jenë rreth 379 MW ndërsa sipas Integritit Gradual të Çmimeve të Karbonit në Treg është 455 MW.⁸⁰ Si rezultat, Kosova është përkushtuar për një sërë veprimesh si vendosja e instrumenteve të çmimit të karbonit dhe skemave mbështetëse të burimeve të ripërtëritshme të bazuara në treg, si dhe heqja graduale e subvencioneve të thëngjillit. Prandaj, zgjidhja optimale për zhvillimin e sektorit energjetik të Kosovës është një model hibrid që përfshin tërheqjen nga thëngjilli dhe tranzicionin në burime të ripërtëritshme të energjisë, me gaz natyror dhe potencialisht me hidrogjen si burim tranzicioni.

Siç shihet në tabelën 8 më poshtë, Gazi Natyror mund të kontribuojë në përbërjen e energjisë dhe të zëvendësojë thëngjillin në prodhimin e energjisë derisa në të njëjtën kohë të ofrojë shërbimet e balancimit të nevojshme për të adresuar ndërprerjen e BRE-ve dhe lehtësojë integrimin e tyre në sistem. Megjithatë, pasi tregjet e gazit mbeten të fragmentuara, investimet në infrastrukturën e gazit nuk po bëhen në EnC ku si pasojë gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor u mohohet në mënyrë efektive qasja në gaz më të lirë dhe më fleksibël. Ndërsa çmimi i karbonit redukton prodhimin e bazuar në lëndë të ngurta, gazi shfaqet si një lëndë djegëse e rëndësishme plotësuese e tranzicionit. Nxënja e potencialit të gazit megjithatë mund të materializohet vetëm në kushtet e integritit të tregut. Njësitë e gazit kryejnë funksionin e rritjes së lartë i nevojshëm për të balancuar luhatjet kryesore të BRE-ve të ndryshueshme dhe lehtësojnë depërtimin e tyre të rritur në sistemin e energjisë elektrike. Zhvillimi i sektorit të gazit natyror dhe krijimi i rezervave energjetike me qëllim të lehtësimit të integritit të burimeve të ripërtëritshme, lehtësojnë varësinë e Kosovës nga thëngjilli dhe mundësojnë qëllimin e

⁷⁹ Ibid.

dekarbonizimit.⁸¹ Për më tepër, opsioni i QK-së është që të marrë një vendim për tri njësitë jofunksionale A1, A2 dhe A3 të TC Kosova A, të cilat mund të dekomisionohen deri në vitin 2025. Dy njësitë e mbetura (A4 dhe A5) të funksionojnë edhe për dhjetë vjet të tjera deri në vitin 2032.

Tabela 8. Nxitësit kyç për kontributin e gazit natyror në përbërjen energjetike të Kosovës

<ul style="list-style-type: none"> - Disponueshmëria dhe çmimet e gazit natyror (GN), marrëdhëniet e çmimeve ndërmjet energjisë elektrike dhe GN -Përdorimi i teknologjive të avancuara për furnizimin me gaz përmes tubacioneve virtuale, gazit natyror të lëngshëm (LNG) - Plotësimi i kërkesave të Agjendës së Gjellbër të BB-së dhe objektivave të EnCT dhe burimeve të ripërtëritshme dhe CO2, duke prezantuar çmimin e karbonit - Zhvillimi i përgjithshëm i tregut rajonal të energjisë elektrike dhe tregtia e energjisë elektrike në rajon (duke përfshirë ndërlidhjet së pari me Shqipërinë, Maqedoninë.V). 	<ul style="list-style-type: none"> -Gazi natyror do të jetë burim për tranzicionin energjetik. - Përfitimet mjedisore - GN do të emetojë dukshëm më pak CO2, NOx dhe SO2. - Reduktimi i ngarkesës me energji elektrike dhe përmirësimi i besueshmërisë së përgjithshme të sistemit elektrik të Kosovës 	<ul style="list-style-type: none"> Në vitin 2030, rrjetet gazit do të jetë në gjendje të transportojë një përzierje që përmban 10% gaze të dekarbonizuara -Deri në vitin 2040, nevojat për ngrohje të të gjitha familjeve do të mbulohen nga NQ dhe me emetim zero ose të ulët. -Infrastruktura e GN do të zhvillohet dhe NQ do të zgjerohet dhe do të sigurohet diversifikimi i dmundësive të furnizimit -NG mund të krijojë sinerji me teknologjitë e ripërtëritshme e për të balancuar prodhimet e ndërprera të energjisë elektrike
---	---	--

Burimi: Analiza e INDEP.

Për sa i përket gazit natyror, Interkoneksioni i gazit me Greqinë (LNG), me Republikën e Maqedonisë, TAP Shqiptar do të rrisë furnizimin e sigurisë në Kosovë dhe do të mundësojë vendosjen e lidhjeve të mëtejshme me rrjetet ndërkombëtare të gazit dhe qendrat e gazit (Korridori Jugor, terminalët e LNG, EUSAIR). Nëse këto projekte nuk realizohen, Kosova do të mbetet në një pozitive shumë të cenueshme për momentin sa i përket sigurisë së furnizimit me energji. Niveli i sigurisë së furnizimit me energji elektrike në Kosovë nuk është ideal, megjithatë nevojitet diversifikimi i mëtejshëm në furnizim dhe gazi natyror është një nga opsionet më të përshtatshme. Përkushtimi i Kosovës ndaj Agjendës së Gjellbër të BE-së për Ballkanin Perëndimor varet nga zhvillimi i planeve konkrete për procesin e dekarbonizimit. Qeveria e re ka filluar hartimin e një strategjie të ardhshme energjetike, e cila do të ketë një ndikim të madh në ekonominë e vendit. Sipas pikëpamjes së BE-së, SHBA-ve (MCC) dhe IFI-së qëndrimi i tyre është të sjellin gazin në Kosovë dhe të gazifikojnë Kosovën siç paraqitet në

⁸¹ Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit në Kosovë. E qasshme në: <https://www.mcc.gov/resources/story/story-cbj-fy2022-compact-assistance>

paragrafët në vijim. Kjo mund të i ofrojë rajonit ⁸² një burim energjie gjerësisht të disponueshme, të sigurt dhe të përballueshme cili do të mbajë rajonin konkurrues në nivel ndërkombëtar, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e ajrit dhe duke ulur emetimet.

Bashkëpunimi rajonal është kritik për dekarbonizimin e Ballkanit meqë është një mënyrë e thjeshtë dhe me kosto të ulët për të arritur sigurinë e dëshiruar të furnizimit me energji elektrike. Kosova duhet të bëjë përpjekje që të përmirësojë bashkëpunimin e saj dhe të punojë drejt integritit të tregut të energjisë brenda rajonit. Për Kosovën është një opsion ideal që të shfrytëzojë asistencën teknike në kuadër të Komisionit Evropian “Programi i shkëmbimit të rajoneve të thëngjillit” respektivisht iniciativa për mbështetjen e tranzicionit në vendet e energjisë së thëngjillit “Rajonet e thëngjillit në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë.”⁸³ Në përputhje me zhvillimin e tubacioneve ndërkombëtare të gazit, ekzistojnë disa opsione për ndërlidhjen e sistemit të gazsjellësit të Kosovës, me: TAP (Trans Adriatic Pipeline), Maqedonia Veriore, терминалет LNG në Greqi dhe terminali i mundshëm LNG në Krk si dhe opsione të tjera përmes projekteve CESEC, EUSAIR dhe PECI/PMI.

Më tej, Kosova filloi të angazhohej në zhvillimin e një rruge të mundshme dhe realiste furnizimi nga Maqedonia e Veriut, si shtesë ose në vend të lidhjes së favorizuar me rrjetin e gazit të Shqipërisë. Interkoneksioni Maqedoni e Veriut – Kosovë po merr vëmendje dhe ka amundësi të marrë ndihmë nga fondet ndërkombëtare.⁸⁴ Për më tepër, sipas projektit të WBIF/BERZH ⁸⁵, një interkonektor gazi me Maqedoninë e Veriut do të ishte një opsion me kosto efektive për importin e gazit. Gjithashtu, *Master Plani i Gazit* për Kosovën është duke u përgatitur nga WBIF ⁸⁶ dhe objektivat kryesore të të tij janë zhvillimi i një masterplani afatmesëm të gazit natyror për Kosovën si dhe identifikimi i projekteve prioritare për investime, duke përfshirë rishikimin e kornizës rregullative dhe asistencën. Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC)⁸⁷ përmes Programit të Kompaktit të Energjisë në Kosovë është duke përgatitur një *Projekt për Zhvillimin e Sektorit të Gazit*.

Prandaj, roli i integritit të tregut është thelbësor për të mundësuar daljen nga thëngjilli, megjithëse kjo ndodh vetëm pas vitit 2040 për shkak të kostove të ulëta të linjtit para kësaj. Në veçanti, fokuson vëmendjen në investimet në терминалет LNG, të cilat ofrojnë një shembull të dobishëm për analizimin e dinamikës që mbështet zgjerimin e varësisë nga gazi në rastin e Kosovës. Prandaj Kosova duhet të planifikojë zhvillimin e infrastrukturës ndërkufitare të gazit natyror për të diversifikuar rrugët e furnizimit dhe për të rritur konkurrencën e tregut. Rezultatet tregojnë se konsumi më i lartë vjetor arrin deri në 650 mil. Nm³ ose 521 ktoeduke pasur parasysh se pjesa më e madhe e konsumit është

⁸² European Commission (2020). ĒB Economic and Investment Plan, available at: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/communication_on_ēb_economic_and_investment_plan_october_2020_en.pdf

⁸³ European Commission (2020). Initiative for coal regions in transition in the Western Balkans and Ukraine. Available at: https://energy.ec.europa.eu/topics/oil-gas-and-coal/coal-regions-ēestern-balkans-and-ukraine/initiative-coal-regions-transition-ēestern-balkans-and-ukraine_en

⁸⁴ Energy Community Secretariat (2020). Implementation Indicator Gas, available at: <https://ēēē.energy-community.org/implementation/Kosovo/GAS.html>

⁸⁵ ĒBIF/EBRD, North Macedonia -Kosovo Gas interconnection, available at: <https://ēbif.eu/project/PRJ-MKD-ENE-016>

⁸⁶ ĒBIF, Gas Master Plan for Kosovo, available at: <https://ēbif.eu/project/PRJ-KOS-ENE-011>

⁸⁷ Millennium Challenge Corporation-Kosovo Compact Project, available at: <https://assets.mcc.gov/content/uploads/Final-Kosovo-Compact-609g-CN-Tranche-II.pdf>

gjatë periudhës së dimrit, kapaciteti i gazsjellësit duhet të jetë së paku dy herë më i lartë se konsumi vjetor. Natyrisht, pa infrastrukturë gazi, Kosova duhet të sigurojë integrimin e infrastrukturës rajonale përmes përfundimit të projekteve të interkoneksionit me Shqipërinë ose Maqedoninë Veriore ose importimin e LNG nga Greqia ose Krk Kroacia. Zhvillimi i infrastrukturës do të mundësojë qasje në tregje më të mëdha, më likuide dhe do të stimulojë hyrjen e kompanive të specializuara të gazit në tregun e Kosovës. Kjo do të sigurojë konkurrencë më të lartë dhe përcaktim të çmimit të gazit të bazuar në treg duke siguruar kështu qëndrueshmërinë e sektorit të gazit me një çmim konkurrues.

Rritja e konsumit të gazit është nxitur kryesisht nga TEC-et për prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes nga NQ. Si rezultat i çmimit të lartë të CO₂, konsumi i gazit është më i lartë dhe kalimi i karburantit nga thëngjilli në gaz tashmë është duke ndodhur në industri. Tutje, çmimi i energjisë elektrike nga termocentralet me gaz mund të jetë më konkurrues se çmimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, kështu që konsumi i gazit për prodhimin e energjisë elektrike do të mbetet i konsiderueshëm. Për të siguruar një qasje holistike për zhvillimin e rrjeteve të shpërndarjes së gazit, është e nevojshme të krijohet një plan veprimi. Sidoqoftë, për këtë, nevojitet koordinimi i Qeverisë dhe komunave, si dhe vullneti politik. Kalimi nga linjiti drejt energjisë më të pastër është një detyrë e vështirë dhe nuk është e krahasueshme me ndonjë reformë apo transformim të realizuar së fundmi nga shoqëria kosovare. Pjesa më e madhe e Evropës Juglindore dhe gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë ende qasje të kufizuara në gaz dhe veçanërisht në furnizime të diversifikuara.

Situata po përmirësohet si rezultat i lidhjeve të reja të gazsjellësit TAP dhe terminaleve të rigazifikimit të LNG. Megjithatë, veçanërisht për vendet më të vogla dhe përgjithësisht më të varfra në rajon, rrjetet e brendshme të shpërndarjes janë të kufizuara dhe do të duhet pak kohë përpara se pjesa më e madhe e rajonit të përfitojë nga gazi me çmime tërheqëse. Ekziston gjithashtu mundësia që gazi natyror të përdoret gjithnjë e më shumë si për prodhimin e energjisë ashtu edhe për ngrohje, jo më pak duke zëvendësuar linjitin. Nga strategjia energjetike e BERZH-it, skenari më i rekomanduar në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor për kalimin nga thëngjilli është ai që promovon një zgjerim të madh të prodhimit të energjisë me gaz. Për më tepër, strategjia thotë se gazi mund të luajë një rol në largimin nga karburantet me intensitet karboni, si thëngjilli, duke mbështetur shkallëzimin e burimeve të ripërtëritshme me ndërprerje dhe duke kaluar në lëndë djegëse më të pastra për të reduktuar emetimet e gazrave serre dhe/ose për të përmirësuar cilësinë e ajrit.

Sipas planit të investimeve ekonomike për Ballkanin Perëndimor për ato vende (përfshirë Kosovën) të cilat varen shumë nga thëngjilli, çelësi për t'u larguar nga thëngjilli në periudhë afatshkurte dhe afatmesme, mund të jetë kalimi në infrastrukturën moderne të gazit me emetim të ulët. Kosova në këtë drejtim si vend kandidat potencial për anëtarësim në BE duhet të ndjekë këshillat e BE-së për riorganizimin e marrëveshjeve për anëtarësim në projekt në përputhje me ligjin e BE-së për energjinë. QK gjithashtu duhet që seriozisht të marrë parasysh këtë dhe të bëjë hapa konkretë për t'u bashkuar me Gazsjellësin Trans-Adriatik. Kosova në mënyrë efektive nuk konsumon gaz natyror, dhe

rrjedhimisht plani për të lidhur ALKOGAP-in⁸⁸ nëpërmjet TAP-it në një rrjet kombëtar të gazit do të ofrojë mundësinë e adoptimit të gazit si burim i konsumit të brendshëm.

Pavarësisht progresit të dobët në zhvillimet e infrastrukturës energjetike dhe ndryshimeve të parëndësishme në modelet e konsumit, qeveria e Kosovës duhet të theksojë rolin e gazit në sistemin e ardhshëm energjetik të vendit dhe veçanërisht në prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes qendrore. Për më tepër, qëndrimi i SHBA-së është që gazi në Kosovë të sjellë gazsjellësin e Maqedonisë së Veriut përmes Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit, programit kompakt energjetik ku po punohet në studimet e gazit për Kosovën dhe lidhjen e mundshme të Kosovës me Maqedoninë e Veriut. Nga intervista me zyrtarët e Korporatës Kosovare për Sfidat e Mijëvjeçarit⁸⁹ mësuam se është hartuar drafti i parë i studimit të gazit.

Së fundi, vendosja e burimeve të ripërtëritshme të energjisë me ndërprerje, kërkon pjesë më të mëdha të gazit në përbërjen energjetike (mixin e prodhimit energjetik). Termocentralet me gaz, të karakterizuara me kosto relativisht të ulëta investimi, mund të përdoren për të ofruar fleksibilitet me kosto të ulët⁹⁰, të cilat mund të lehtësojnë integrimin e energjisë së erës dhe asaj diellore në sistemin energjetik. Teknologjitë për djegje të gazit janë aktualisht më konkurruese se çdo teknologji e ruajtjes së energjisë.⁹¹ BE-ja është e përqendruar në projekte infrastrukturore që mund të kontribuojnë në dekarbonizimin e konsiderueshëm brenda sektorit të energjisë (hidro, burimet e ripërtëritshme, gazi natyror, etj.) në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Shtetet e Bashkuara mbeten një burim i rëndësishëm i ndihmës së huaj për Kosovën, në sektorin e energjisë përmes programit kompakt të MCC.

Siç u përmend më herët, Kosova nuk ka infrastrukturë të gazit, prandaj nuk ka lidhje me sistemet ndërkombëtare të transmetimit të gazit. Zhvillimi i tregut të gazit në Kosovë me të gjitha zhvillimet e reja të gazit në rajon dhe funksionalizimi i TAP-it është një domosdoshmëri dhe do t'i mundësojë vendit që a) të rrisë sigurinë e furnizimit; b) tërheqjen e investimeve në sektorin e gazit natyror; c) pjesëmarrje në tregun rajonal të gazit natyror. Integrimi i suksesshëm i tregut të gazit për Kosovën do të kërkojë zhvillimin e një rrjeti kombëtar të gazit që do të jetë mjaft i fuqishëm për të përmbushur nevojat e parashikuara të konsumatorëve dhe për të arritur standardet evropiane dhe përfshirjen e Kosovës si pjesë e një rrjeti nën-rajonat të gazit që mundëson zhvillimin e infrastrukturës, duke synuar kështu kërkesë më të madhe nën-rajonale.

Ndërsa integrimi i tregut të furnizimit me gaz do të sigurojë shpërndarjen e gazit në tregun e brendshëm dhe do të forcojë ekonominë kombëtare. Pengesat kryesore për dekarbonizim të qëndrueshëm janë çmimet artificialisht të ulëta të energjisë në vend. Janë tejet të subvencionuara nga qeveria dhe nuk mund të mbulojnë investimet e nevojshme kapitale për sektorin e energjisë. Për shkak

⁸⁸ Energy Community Treaty. available at: <https://ëëë.energy-community.org/regionalinitiatives/infrastructure/PLIMA/Gas13.html>

⁸⁹ Personal Interview with the public official from the MCC program

⁹⁰ P. Denholm, R.M. Margolis (2007). Evaluating the limits of solar photovoltaics (PV) in traditional electric power systems Energy Policy, 35 (5) pp. 2852-2861

⁹¹ D. Elliott (2016). A balancing act for renewables Nat. Energy.

se Komuniteti i Energjisë i shpalli vazhdimisht subvencionet e thëngjillit shkelje të rregullave të ndihmës shtetërore të shteteve të tij anëtare, duket se, përveç burimeve të rinovueshme, gazi natyror duhet të jetë opsioni i preferuar nga qeveria e re. Në periudhë afatshkurtë, gazi natyror do të reduktonte pasojat negative të dekarbonizimit për ekonominë dhe stabilitetin energjetik. Në vijim, ne paraqesim katër opsionet e mundshme të futjes së gazit natyror në Kosovë për tejkalimin e hendekut të mbetur për përbushjen e kërkesës së brendshme dhe përbushjen e zotimeve mjedisore për Kosovën neutrale ndaj karbonit deri në vitin 2050.

6.1. OPSIONI 1. Ftuja e gazit natyror nëpërmjet Shqipërisë - Gazsjellësi TAP

Projekti i Gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP) u krijua për të forcuar bashkëpunimin rajonal midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit në përbushjen e kërkesave për gaz natyror duke garantuar gjithashtu sigurinë dhe qëndrueshmërinë energjetike brenda rajonit. Aktualisht, asnjë tubacion gazi nuk e lidh Shqipërinë me Kosovën dhe as me tregje të tjera të mëdha rajonale. Bazuar në studimet e fundit, supozohet se i gjithë konsumi i ardhshëm i gazit në Shqipëri do të furnizohet nga TAP dhe Gazsjellësi Jon-Adriatik (IAP). Projekti IAP synon të lidhë sistemin ekzistues të transmetimit të gazit të Kroacisë përmes Malit të Zi dhe Shqipërisë me sistemin TAP, i cili pritet të jetë funksional pas vitit 2020. Kosova deri më tani nuk është ende pjesë e ENTSO-G, por po vazhdon punën e saj për të u bërë pjesë e këtij rrjeti evropian.

Opsioni ideal për futjen e gazit natyror në Kosovë është përmes gazsjellësit Shqipëri - Trans Adriatik. Për këtë arsye, është bërë *studimi i parafizibilitetit për projektin ALKOGAP*, i financuar nga Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (ËBIF) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).⁹² Edhe pse nuk ka infrastrukturë të gazit, Kosova mund të përfitojë nga pozicioni i saj gjeografik në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe të bëhet një aktor në zhvillimin e një rrjeti rajonal për transmetimin e gazit duke u bërë pjesë e TAP-it përmes ALKOGAP-it.

Studimi paraprak i fizibilitetit ALKOGAP ka dhënë rekomandime përcjellëse, përgatitjen e një masterplani për shpërndarjen e gazit natyror në Kosovë dhe më pas ka inicuar studimin e plotë të fizibilitetit për gazsjellësin Shqipëri-Kosovë dhe një studim tjetër për mjedisin dhe ndikimin social.⁹³ Në këtë studim para-fizibiliteti është vlerësuar kërkesa për gaz natyror dhe në një masë të vogël, ka përfshirë një impiant për prodhimin e energjisë elektrike, industrinë me tre prodhuesit më të mëdhenj si Sharrcem, Feronikeli dhe Trepça, por edhe pjesën tjetër të industrisë.⁹⁴ Qasja potenciale e rajonit në burimet e reja të furnizimit me gaz ofron një mundësi për të diversifikuar burimet e furnizimit me energji.

Përzgjedhja e TAP-it si rruga kryesore e eksportit për gazin azerbajxhanas nga zhvillimi i gazit të Kaspikut Shah Deniz II ofron një mundësi për rajonin e Ballkanit Perëndimor për të marrë qasje në

⁹² Personal Interview with the public official from the Ministry of Economy.

⁹³ Ibid.

⁹⁴ Personal Interview with the public official from the Energy Regulatory Office

burimet e gazit të Kaspikut.⁹⁵ TAP do të ofrojë mundësinë e gazifikimit të Kosovës dhe rajonit përmes linjave nxitëse dhe rritjes së flukseve drejt vendeve me qasje të kufizuar. Ndikimi më i drejtpërdrejtë i TAP-it në rajon do të jetë kështu si një mjet për të përmirësuar integrimin rajonal dhe ka mundësi të stimulojë bashkëpunimin e mëtejshëm në infrastrukturë, siguri dhe harmonizim ligjor.




Figura 6. Projektet e infrastrukturës rajonale të gazit dhe opsionet për kyçe të Kosovës (përfshirë ALKOGAP)

Siç është ilustruar në figurën 6 më lart, zhvillimet e fundit dhe ndërtimi i nisur i Gazsjellësit Trans-Anatolian i Gazit Natyror (TANAP) dhe shtrirja e tij në TAP si korridor për furnizimin me gaz nga Deti Kaspik në Evropë, krijojnë parakushtet e nevojshme për futjen e gazit natyror në tregjet aktualisht inekzistente të gazit natyror të Kosovës dhe Shqipërisë. Të dy projektet me interes të madh për Kosovën, ALKOGAP dhe Maqedonia e Veriut – Kosovë⁹⁶ ndërlihdësi i gazit janë gjithashtu pjesë e listës së re për Projektin e Interesit të Komunitetit të Energjisë (PECI 2020).

ALKOGAP synon të ndërlihdë sistemin ekzistues dhe të planifikuar të transmetimit të gazit të Shqipërisë (përfshirë projektin TAP dhe IAP) me sistemin e ardhshëm të projektuar të transmetimit të gazit të Republikës së Kosovës, dhe ndërlihdësit e transmetimit, të cilët janë pjesë e degës lindore të Unaza e Gazit e Komunitetit të Energjisë. Për më tepër, projekti ALKOGAP⁹⁷ megjithatë do të planifikohet si një tubacion dy-drejtimësh, kështu që drejtimi i mundshëm i furnizimit mund të jetë gjithashtu veri-jug, nga Unaza e Gazit e Komunitetit të Energjisë, ose burime të tjera. Përfitimet për Kosovën do të përfshijnë:

- futja e një burimi energjie më të pranueshëm për mjedisin në rajon;
- furnizim të diversifikuar me gaz në rajon dhe qasje në kapacitetet magazinuese shqiptare;
- kapacitet të konsiderueshëm tranziti dhe të ardhura për Shqipërinë dhe Kosovën;

⁹⁵ The World Bank Report (2018). Western Balkans: Directions for the Energy Sector available at: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/201391544823541838/pdf/Eestern-Balkans-Energy-Directions-Paper.pdf>

⁹⁶ Energy Community, Gas_26 Gas Interconnection North Macedonia – Kosovo, available at: https://author.energy-community.org/enc-author-prd/enc/aboutus/secretariat/PCs/PC_PECI/questionnaire/Gas_26.html

⁹⁷ Energy Community, Albania – Kosovo Gas Pipeline ALKOGAP-Project description, available at: <https://ec.europa.eu/energy-community.org/regionalinitiatives/infrastructure/PLIMA/Gas13.html>

- gatishmërinë e institucioneve financiare ndërkombëtare për të investuar dhe krijimi i vendeve të punës.
- krijimi i parakushteve për mbështetjen e konceptit rajonal të Unazës së Gazit të Evropës Jugore;
- reduktimin e emetimeve të CO2 në rajon dhe fasilitimin e zhvillimit ekonomik.

Tabela 9. Parametrat kryesorë nga Gazsjellësi Shqipëri - Kosovë

Interkonektori i gazit nga Miloti në Shqipëri në Prishtinë në Kosovë	Masa
Diametri	DN600 (24")
Presioni operativ	82 bar
Gjatësia e tubit në Shqipëri	113 km
Gjatësia e tubit në Kosovë	99 km
Kapaciteti në vit	1 bcm
Kosto	circa 211 milion EUR

Burimi: Studimi paraprak i fizibilitetit për ALKOGAP ⁹⁸

Ashtu siç pasqyrohet në figurën 7 më poshtë, një stacion kompresori potencial do të vendoset në Dardhë (afër kufirit Shqipëri-Kosovë, brenda territorit të Shqipërisë. Duke qenë se në Shqipëri nuk ka transmetim gazi, ALKOGAP do të zbatohet pas ndërtimit të IAP.




Figura 7. Linjat e gazsjellësit ALKOGAP me TAP dhe IAP në Kosovë dhe Shqipëri ⁹⁹

⁹⁸ Energy Community, Albania – Kosovo Gas Pipeline ALKOGAP-Project description, available at: <https://www.energy-community.org/regionalinitiatives/infrastructure/PLIMA/Gas13.html>

⁹⁹ Ibid.

6.2. OPSIONI 2. Futja e gazit natyror përmes gazsjellësit në Maqedoninë e Veriut

Një opsion i rëndësishëm potencial i furnizimit me gaz natyror për Kosovën mbeten *furnizimet në dispozicion nga Maqedonia Veriore dhe Greqia*. Edhe pse ka pasur një rrugë e cila transportonte gaz artificial të nxjerrë nga thëngjilli në TC Kos A, pra nuk është saktësisht gaz natyror, dhe transportohej në Shkup në fabrikën e aluminit.¹⁰⁰ Kjo rrugë ka ekzistuar brenda Kosovës, por sistemi nuk është përdorur që nga viti 1986. Është totalisht jashtë funksionit dhe të gjitha pjesët e tij janë shkatërruar. Sistemi më parë furnizonte gazin e qytetit, të prodhuar në Obiliq, për Prishtinën, Mitrovicën dhe Shkupin në Maqedoninë e Veriut. Edhe pse fillimisht i projektuar për një presion operativ prej 25 bar dhe një kapacitet vjetor prej 0.2 bcm, pronarët aktualë të gazsjellësit zyrtarë nga Korporata Elektroenergetike e Kosovës - KEK¹⁰¹ kanë deklaruar se sistemi është dëmtuar plotësisht në disa zona për shkak të punimeve të ndërtimit të palëve të treta në dhe përreth tubacionit. Për më tepër, gazsjellësi *Kosovë (Prishtinë) – Shkup (Maqedonia e Veriut)* mbetet i qartë dhe i zbatueshëm dhe kapaciteti i disponueshëm në rrjedhën e sipërme dhe furnizimet në dispozicion nga Maqedonia V.dhe Greqia. Financimi i pritshëm për funksionalizimin e këtij gazsjellësi të ardhshëm do të vijë nga WBIF/EBRD si dhe projekti MCC¹⁰² në Kosovë. Rruga e gazit natyror për në Maqedoninë Veriore¹⁰³, ka treguar se në aspektin e financimit, ashtu edhe në atë të zbatimit (distancë, terren), u konstatua se është më i favorshëm se ai me Shqipërinë. Ky opsion i furnizimit me gaz në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor pritet të rritet me TAP-in, alternativat e furnizimit të Kaspikut dhe importin e LNG nga Greqia. Fluksi i parashikuar i furnizimeve konkurruese të gazit në rajon do të sjellë stabilitet çmimesh dhe tepriçë të furnizimit që do të mbështesë zhvillimin e industrisë së gazit natyror të Kosovës. MCC me BERZH dhe WBIF dhe IF e tjera mund të përfshijnë paketën e investimeve siç vijon: Transmetimi i Gazit. MCC investon në segmentet e gazsjellësit të Kosovës - Maqedonisë Veriore nga Ferizaj në Prishtinë.¹⁰⁴

Tabela 10. Përparësitë dhe Dobësitë e Gazsjellësit Kosovë-Maqedoni e Veriut

<i>Përparësitë</i>	<i>Dobësitë</i>
E drejta e kalimit të gazsjellësit të propozuar mbetet e qartë dhe e zbatueshme	Gazsjellës i vjetër jofunksional
Kapaciteti i disponueshëm në rrjedhën e sipërme dhe furnizimet në dispozicion nga Maqedonia Veriore dhe Greqia	Kapaciteti vjetor (bcm) nuk është i siguruar për këtë linjë?
Funksionalizimi i shpejtë i gazsjellësit (tubacioni i shkurtër rreth 80 km)	Implikimet mjedisore (flora dhe fauna)

¹⁰⁰ Personal Interview with the public official from the ERO

¹⁰¹ Personal Interview with the public official from the KEK

¹⁰² Personal Interview with the officials from ERO

¹⁰³ Ibid

¹⁰⁴ Personal Interview with the public official from the MCC program

Potencial për fatura më të ulëta për klientët e energjisë pas vendosjes së çmimit të karbonit

Burimi: Analiza e INDEP

Ligjërisht, lehtësimi përgjatë rrugës Kosovë drejt Maqedonisë së Veriut duhet të jetë në dispozicion për ndërtimin e një gazsjellësi të ri, që paraqet një nga mundësitë për t'u përdorur si rrugë e drejtë për transmetimin e rrjetit të zhvillimit të gazit natyror në lindje të vendit (Kosovë-Hani i Elezit). Megjithatë, një vlerësim i interkoneksionit të mundshëm të gazit ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut është duke u hartuar nga ekspertët e angazhuar nga programi kompakt MCC.¹⁰⁵ Këto të dhëna do t'u jepnin përdoruesve të energjisë një opsion më efikas të energjisë termike, do të mbështesnin tranzicionin energjetik të Kosovës dhe do të kontribonin në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Projekti do të përfshijë një koleksion të tubacionit transmetues dhe shpërndarës, asistencë teknike për të vendosur menaxhimin e sektorit, si dhe një fond lidhjeje për të i mundësuar konsumatorëve me të ardhura më të ulëta të përfitojnë nga programi.

Projekti gjithashtu synon të diversifikojë rrugët e gazit dhe burimet e furnizimit për Kosovën, gjë që do të inkurajonte përdorimin e gazit duke e bërë atë më tërheqës dhe më rezistent ndaj ndërprerjeve të furnizimit.¹⁰⁶ Një opsion tjetër për furnizim me gaz mund të vijë nga tubacioni ekzistues i naftës nga Selaniku në Shkup, i konvertuar në gaz transporti, i cili është në gjendje të dërgojë rreth 1 miliard cm³ për vit në Shkup dhe të sigurojë diversitet furnizimi për konsumatorët maqedonas dhe kosovarë.¹⁰⁷ Sipas studimit të fizibilitetit ¹⁰⁸ një ndërlidhës gazi me Maqedoninë e Veriut shihet si opsioni më ekonomik për importin e gazit dhe ka të gajë të kontribuojë në zëvendësimin e linjitet për prodhimin e energjisë.

6.3. OPSIONI 3. Vendosja e LNG-së në shkallë të vogël në “tubacionet virtuale të Kosovës”

Ndryshimet në teknologjinë për gazin natyror të lëngshëm (LNG), si deponimi lundruar dhe rigazifikimi, kanë përmirësuar opsionet e furnizimit me gaz kur infrastruktura është e kufizuar dhe lëngëzimi ka mundësuar transportin e gazit në vende me infrastrukturë të kufizuar ose pa tubacion. Një opsion tjetër për të sjellur gazin natyror në Kosovë është përmes mënyrës së disrtrbuimit të LNG-së në shkallë të vogël pra, përmes “tubacioneve virtuale”. Meqë politika energjetike e BE-së dhe objektivat mjedisore në sektorin e energjisë përfaqësojnë bazën për shqyrtimin e aplikimit më të gjerë të LNG-së në konsumin e energjisë në periudhën e tranzicionit. Sektori i transportit, siç u përmend më herët, përfaqëson një nga çështjet problematike pasi elektrifikimi i kamionëve të rëndë në trafikun

¹⁰⁵ Personal Interview with the official from Millennium Challenge Corporation (MCC).

¹⁰⁶ Personal Interview with the public official from the Ministry of Economy.

¹⁰⁷ Oxford Institute for Energy Studies (2017). Točards-a-Balkan-gas-hub, available at: <https://ëëë.oxfordenergy.org/ëpcms/ëp-content/uploads/2017/02/Točards-a-Balkan-gas-hub-NG-115.pdf>

¹⁰⁸ Personal interview with MCC official.

rrugor apo transportin detar nuk është një alternativë në një të ardhme të afërt. Prandaj, përdorimi i LNG-së paraqet alternativë në periudhën tranzitore drejt një shoqërie të qëndrueshme energjetike.

Në rajonin e Ballkanit Perëndimor siguria e furnizimit me gaz është përmirësuar viteve të fundit si rezultat i ndërtimit të terminalit të LNG 'Alexandropolis' në Greqi.¹⁰⁹ Si dhe terminalit LNG në Krk, Kroaci¹¹⁰. Nga viti 2020 e tutje, gazi mund të vijë me tubacion nga Kaspiku, nëpërmjet Gazsjellësit Trans Adriatik, si dhe nga терминаlet e reja dhe të zgjeruara të LNG në Greqi dhe terminali LNG në Kroaci. Shpërndarja alternative e gazit përmes transportit sipërfaqësor të Gazit Natyror të Lënguar (LNG) në mbarë Kosovën.

Burimi potencial i furnizimit të tregut të gazit natyror të Kosovës është terminali LNG i ishullit Revithoussa afër Athinës¹¹¹. Për të sjellur LNG në Kosovë, ekzistojnë tri mënyra transportimi:

1. Kontejnerët Cryo mund të përdoret për transport dhe për ruajtje afatshkurte në vendin e rigazifikimit. Ato mund të transportohen me hekurudhë (në vagon të hapur) dhe më pas të shkarkohen në vend, të lidhen me objektin e rigazifikimit dhe të përdoren. Kontejnerët Cryo gjithashtu mund të transportohen nga një vagon hekurudhor në një rimorkio kamioni dhe më pas të transportohen më tej në lokacionin përfundimtar. Kontejnerët e zbrazët do të transportoheshin përsëri në stacionin e mbushjes (d.m.th. në Revithoussa, Greqi) dhe do të duke u përdorur mënyrë qarkore. Në këtë rast nuk ka nevojë për ruajtje fikse të LNG në терминаlet e rigazifikimit. Përdorimi i optimizuar i kontejnerëve Cryo ofron fleksibilitet në lidhje me hapësirën e magazinimit dhe mund të rritet ndërsa konsumi i marrjes së gazit natyror po bëhet më i madh.
2. Vagonat e trenave LNG mund të mbushet në terminalin e furnizimit (d.m.th. në Revithoussa Greqi), transportuar me hekurudhë deri në Kosovë (në vendndodhjen e stacionit kryesor të ardhshëm të rigazifikimit dhe shpërndarjes në Prishtinë) ku LNG do të shkarkohet në rezervuarët fiks të LNG të ndërtuar si pjesë e stacionit të rigazifikimit. Për këtë, rezervuarët fiks të LNG-së duhet të ndërtohen, ose si rezervuarë betoni me përmbajtje të plotë, ose si rezervuarë modularë të depozitimit të LNG-së (vertikale ose horizontale) të bëra prej çeliku, të cilët mund të blihen dhe vendosen në vend. Ky opsion është me kosto më të lartë, por është më i përshtatshëm për vëllime më të larta (kur kërkesa për gaz është e lartë) dhe siguron një kosto më të lirë për njësi. Kjo alternativë e LNG-së kërkon ndërtimin e stacionit kryesor të pranimit/rigazifikimit të LNG-së në Kosovë.
3. Transporti me kamion LNG, burime të tjera furnizimi mund të vijnë nga importimi i gazit nga terminali i ardhshëm i LNG në Krk Kroaci dhe terminali i rigazifikimit të Aleksandropolis në Greqi përmes Maqedonisë duke përdorur opsionin e transportit me kamion LNG.

¹⁰⁹ Gastrade projects. Available at: <http://www.gastrade.gr/en/the-company/the-project.aspx>

¹¹⁰ First-Croatian-LNG-terminal-officially-inaugurated-Krk-island. available at: <https://ec.europa.eu/inea/en/nees-events/neesroom/first-croatian-lng-terminal-officially-inaugurated-krk-island>

¹¹¹ Revithoussa LNG Terminal. Available at: <https://www.desfa.gr/en/national-natural-gas-system/lng-facility>

6.4. OPSIONI 4. Ndërtimi i termocentralit me gaz natyror në Kosovë

Opsioni praktik i sjelljes së gazit natyror në Kosovë është ndërtimi i termocentralit të ri me gaz - Turbina e Gazit me Cikël të Kombinuar (CCGT) me sistem të ruajtjes së energjisë së baterive dhe kapacitet të instaluar prej 250 MW. Ky termocentral i ri me gaz do t'i shtojë miksit energjetik të Kosovës potencialisht në vitin 2027 ose 2028; që mund të zëvendësojë pjesërisht impiantet e linjitet dhe variablin e bilancit të BRE. Përveç këtij fleksibiliteti, impiantet CCGT mund të ndërtohen relativisht shpejt me kosto të arsyeshme dhe gjithashtu mund të përdorin hidrogjenin si lëndë djegëse deri në 30%. Koha mesatare e ndërtimit është dy vjet dhe investimet ndryshojnë ndërmjet 50-60 €/MËh ndërsa edhe kostot operative janë relativisht të ulëta, 19-26 €/kW¹¹². Bazuar në IEA¹¹³, Prodhimi me gaz ka një kosto të nivelizuar të energjisë (LCOE) prej 90 \$/MWh (~76 €/MËh). Zhvillimi i kapaciteteve shtesë të gazit ndodh pas vitit 2027 me ndërtimin e ri të impianteve të gazit të zjarrit që mund të funksionojnë me një efikasitet prej 60%.¹¹⁴ Rrjedhimisht, ato kontribuojnë në kursim të konsiderueshëm të energjisë nëse zëvendësojnë termocentralet e vjetra me efikasitet më të ulët.

Është e rëndësishme të theksohet se intensiteti mesatar i emetimit të fuqisë me gaz natyror është afërsisht 60% më i ulët se ai i energjisë me thëngjill (përkatësisht 430 kg CO₂/MËh dhe 1000 kg CO₂/MËh)¹¹⁵. Impiantet me gaz kryesisht funksionojnë gjatë orëve të pikut¹¹⁶ dhe kanë nivelin më të lartë të fleksibilitetit pasi mund të ndizen dhe fikën relativisht lehtë, në varësi të profilit të kërkesës. Prodhimi i energjisë me gaz natyror është plotësues për sistemet me përqindje të lartë të TEC-eve të thëngjillit si në rastin e Kosovës. CCGT kanë kosto fikse relativisht të ulëta dhe për këtë arsye mund të jenë të realizueshme edhe si impiante pa ngarkesë bazë, duke gjeneruar energji për të balancuar prodhimin e ndërprerë nga burimet e ripërtëritshme, duke siguruar energji elektrike me ngarkesë maksimale dhe gjithashtu duke ofruar shërbime dytësore për sistemin elektrik si balancues. Funksionimi i mundshëm komercial i një impianti të ri me gaz mund të pritët të fillojë që nga viti 2028. Në këto kushte, llogaritja e ngarkesës së furnizimit parashikohet të jetë rreth 20 vjet, periudha kohore (2028-2048), e cila mund të konsiderohet ekonomikisht e qëndrueshme për të gjitha projektet e këtij lloji.

¹¹² European Commission, (2008). Second Strategic Energy Review, Energy Sources, Production Costs and Performance of Technologies for Power Generation, Heating and Transport, Brussels, p. 4

¹¹³ IEEFA. (2020). Beyond coal Investing in Kosovo's Energy future. Available at: https://ieefa.org/ép-content/uploads/2020/09/Beyond-Coal_Investing-in-Kosovos-Energy-Future_October-2020.pdf?utm_source=rss&utm_medium=rss&utm_campaign=beyond-coal_investing-in-kosovos-energy-future_october-2020

¹¹⁴ Power engineering website. available at: <https://www.powerengineeringint.com/coal-fired/equipment-coal-fired/gas-turbines-breaking/>

¹¹⁵ Office of Energy Policy and Systems Analysis (2016). U.S. Department of Energy. Environment Baseline, Volume 1: Greenhouse Gas Emissions from the U.S. Power Sector.

¹¹⁶ Ibid.




Figura 8. Kosto e prodhimit të nivelizuar të energjisë elektrike impianti i gazit në krahasim me impiantin e linjtit

Siç shihet në figurën 8 në lidhje me kushtet ekonomike, gazi mund të jetë më konkurrues se thëngjilli në afat të gjatë, por ka pasiguri të konsiderueshme rreth evolucionit të çmimeve të karburantit dhe kostove mjedisore. Krahasimi i gjenerimit të LCO, i cili është më i përshtatshëm kur krahasohet gazi i ri me thëngjillin e ri, tregon se gazi është opsioni i preferuar kur merren parasysh kostot mjedisore të prodhimit me linjit (duke përfshirë CO₂, NO_x dhe SO₂).¹¹⁷ Megjithatë, një shumëllojshmëri e shtigjeve me karbon të ulët kërkon diskutim dhe veprim të mëtejshëm; Gama e opsioneve të paraqitura, në fakt, mund të trasojë rrugën drejt një vendimi sfidues në një mjedis kontestues. Fokusi në menaxhimin e rrezikut përmes diversifikimit të burimeve (sjellja e gazit natyror), ku Kosova aktualisht mbështetet në 95% linjit, mund të zvogëlojë rritjet e fundit të çmimeve me të cilat janë përballur konsumatorët për shkak të kapaciteteve jo të besueshme gjeneruese nga TC Kosova A dhe Kosova B. Termocentrali i ri me gaz do të duhet të demonstrojë se: projekti nuk mund të zëvendësohet në mënyrë praktike nga burime të ripërtëritshme të energjisë; se kontribon në sigurinë e brendshme të energjisë; dhe se është në përputhje me një drjetim realist të tranzicionit të energjisë. Mbështetje për energjinë e gazit ku kjo mbështet dekomisionin e thëngjillit, së bashku me një rritje të shpejtë të burimeve të ripërtëritshme dhe ku burimet e ripërtëritshme nuk mund të plotësojnë kërkesën gjenerale menjëherë. Kjo do të ndihmonte drejt procesit të dekarbonizimi dhe do të e shpiente drejt një rrugë neto zero.

Duke marrë parasysh të gjithë ENCT-të dhe Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor që Kosova duhet të përmbushë, indikacionet janë në eliminimin e kapaciteteve të thëngjillit në kuadër të integritimit në treg vetëm në ose pas vitit 2045. Megjithatë, që ky opsion të jetë i zbatueshëm nga qeveria, linja e tubacionit të gazit natyror dhe kontrata e furnizimit duhet të vendosen në kohë për vënien në punë të turbinave/motorëve me gaz. Me sjelljen e gazit, kërkesa për prodhimin e thëngjillit mund të zhduket pas vitit 2040 ose pas 12 viteve të funksionimit të centralit të ri me gaz. Tutje, futja e gazit natyror në portofolin e energjisë elektrike të Kosovës deri në vitin 2028 dhe gazi natyror mund të fasilitojë në mënyrë të shpejtë një rritje të PV-ve diellore për shkak të aftësisë për të shërbyer si një

¹¹⁷ The World Bank (2018). Western Balkans: direction for the energy sector, available at: <https://documents1.eorlbank.org/curated/en/201391544823541838/pdf/Èestern-Balkans-Energy-Directions-Paper.pdf>

